

**Arsim BAJRAMI**

## **ASPEKTET KUSHTETUESE DHE POLITIKE TË PAVARËSISË SË KOSOVËS (1989-1999)**

### **Abstrakt:**

*Shpërbërja e ish-Federatës Jugosllave, e filluar me rrënimin e konceptit kushtetues të pozitës së Kosovës në vitin 1989, me shkëputjen dhe njohjen ndërkombëtare të katër njësive federale, si dhe fillimin e luftës në truallin e ish-Jugosllavisë, hapën procese të reja politike që karakterizohen nga shpërbërja e shtetit federativ dhe krijimi i shteteve të reja sovrane e të pavarura. Duke u nisur nga fakti se koncepti federativ i Jugosllavisë, i bazuar në vendimet e Mbledhjes së Dytë të KAÇKJ-së pushoi së ekzistuari dhe pasi dështuan të gjitha bisedimet politike rreth ripërkufizimit të Jugosllavisë në formë të Federatës a të Konfederatës, filloi procesi i dekompozimit të saj.*

**Fjalët kyçe:** *Kosova, ish-Jugosllavia, Federata Jugosllave, ish-Federata, Kushtetuta.*

### **Shpërbërja e ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe lindja e Republikës së Kosovës - dimensionet kushtetuese**

Më 23 mars 1989, nën kërcënimin e armëve dhe të votave të joparlamentarëve, parlamenti krahinor (tanimë serb) shfuqizoi statusin autonom të Kosovës. Ky ishte edhe një fillim i politikës brutale të

shtypjes së popullit shumicë shqiptar në Kosovë<sup>1</sup>. Këtu kishte filluar një proces i ri për fatin e Kosovës që shkonte paralelisht me shpërbërjen e ish-Jugosllavisë. Në dekompozimin e ish-Federatës Jugosllave ndikuan shumë faktorë<sup>2</sup>, nga të cilët po veçojmë këta:

1. Rrënimi kundërkushtetues i subjektivitetit politik të njësive autonome, të përcaktuar me zgjidhjet e Kushtetutës së vitit 1974, me amendamentet kushtetuese të Kushtetutës së RS të Serbisë, datë 23 mars 1990.

2. Nxjerrja e një morie ligjesh në njësitë federale, me të cilat në territorin e tyre, u bë suspendimi i aplikimit të legjislacionit federativ. Përmes këtyre ligjeve (të cilat në fillim u nxorën në Serbi e më vonë edhe në Slloveni e Kroaci) republikat morën kompetencat e organeve federative dhe në mënyrë të njëanshme braktisën aplikimin e legjislacionit federativ.

3. Dështimi i bisedave të kreut më të lartë politik e shtetëror të gjashtë njësive federale (gjashtë kryetarëve të republikave lidhur me ripërkufizimin e Federatës Jugosllave. Këto biseda ishin jolegjitime, ngase nga to, në mënyrë kundërkushtetuese, ishte përjashtuar Kosova, e cila ashtu si edhe republikat, sipas Kushtetutës së RFJ-së të vitit 1974, ishte subjekt i barabartë dhe konstitutiv (i federalizmit).

4. Fillimi i luftës në Jugosllavi, në fillim në Slloveni e pastaj në Kroaci dhe në Bosnjë e Hercegovinë.

5. Shkëputja dhe njohja ndërkombëtare e katër republikave të ish-Jugosllavisë, të cilat u konstituan si shtete sovrane dhe të pavarura.

---

<sup>1</sup> Joschka Fischer, “*Vitet kuq-gjelbër*”, botimet “KOHA”, Prishtinë, 2008, 99-100.

<sup>2</sup> Trajtimi i disa faktorëve të shpërbërjes. Shih p.sh.: Dejan Marolov, “*The Reasons for the Collapse of Yugoslavia*”, Goce Delchev University, Pance Karagozov 31, 2000, Republic of Macedonia. International Journal of Sciences: Basic and Applied Research (IJSBAR), 254-257.

6. Krijimi i të ashtuquajturës RF e Jugosllavisë, e cila në aspektin kushtetues, “rrumbullakosi” procesin e shpërbërjes së Federatës Jugosllave, duke shpallur të vetëquajturin shtet federativ, të përbërë nga dy njësi federale - Serbia dhe Mali i Zi (Unioni u shpërbë, ndërkohë u krijuan shtete sovrane).<sup>3</sup>

7. Nacionalizmi i shprehur i Serbisë në kuadër të Federatës.<sup>4</sup>

Procesi i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, bëri aktualizimin e çështjes së realizimit të së drejtës së vetëvendosjes së popujve që jetonin në ish-Jugosllavi. Duke u inkorporuar në proceset politike, që lindën në sajë të shpërbërjes së RSFJ-së, edhe populli shqiptar, si një nga popujt numerikisht më të mëdhenj të Jugosllavisë (i treti për nga numri i banorëve), nëpërmjet organeve të veta legjitime (kuvendit) dhe në vetëpërcaktim gjithëpopullor (referendum) shprehu vullnetin dhe të drejtën natyrore, që të jetë i lirë dhe i mëvetësishëm në përcaktimin e statusit të vet kushtetues dhe politik.

Në këtë drejtim, më 2 korrik të vitit 1990, të 111 delegatët e Kuvendit të Kosovës miratuan dhe shpallën Deklaratën Kushtetuese për Kosovën si njësi e pavarur dhe e barabartë në kuadër të Federatës-Konfederatës së Jugosllavisë, si subjekt i barabartë me njësitë e tjera federale në Federatë-Konfederatë.

Materializimin e vet kushtetues, Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut e mori më 7 shtator të vitit 1990 kur në Kaçanik, Kuvendi i Kosovës e miratoi dhe e shpalli Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me të cilën bëhej avancimi i pozitës kushtetuese juridike të Kosovës, nga njësi autonome në republikë të pavarur, në kuadër të bashkësisë së Jugosllavisë. Pas fillimit të procesit të shpërbërjes së ish-Federatës Jugosllave dhe pas shkëputjes nga ish-Jugosllavia të katër republikave, edhe populli shqiptar në referendumin gjithëpopullor, më 26-30 shtator 1991, në mënyrë plebishitare u deklarua për konstituimin e Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur. Në pajtim me

<sup>3</sup> Shih më shumë: Stipe Mesiq, “*Si u shkatërrua Jugosllavia*”, Prishtinë 2011.

<sup>4</sup> Vesna Pesic “*Serbian Nationalism and the Origins of the Yugoslav Crisis*”, United States Institute of Peace, Prill 1996, 9-14.

këtë deklaram politik të popullit shqiptar, Kuvendi i Kosovës më 18 tetor 1991, e miratoi Rezolutën për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur. Deklarimi i Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur krijoi situatë të re kushtetuese, e cila imponoi ndryshimet adekuate në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim, Kuvendi i Kosovës, më 19 tetor 1991, miratoi amendamentin I, me të cilin Republika e Kosovës, përcaktohet si shtet sovran dhe i pavarur dhe me amendamentet II-VI, me të cilat institucioni i Kryesisë së Kosovës zëvendësohet me kryetarin e Republikës, si shef individual i shtetit, si dhe bëhet bartja e kompetencave të Kuvendit në Qeverinë e Kosovës gjatë kohës derisa të zgjatin rrethanat e jashtëzakonshme.

Miratimi i amendamenteve kushtetuese në Kushtetutën e Republikës së Kosovës mundësoi mbajtjen e zgjedhjeve të para shumëpartiake parlamentare dhe presidenciale, më 24 maj 1992 kur u zgjodhën deputetët për Kuvendin e Kosovës dhe kryetari i Republikës së Kosovës. Edhe pse Republika e Kosovës u shfaq në kohën kur shteti serb, në mënyrë kundërkushtetuese rrënoi mëvetësinë politike të Kosovës (dhe bëri okupimin policor dhe ushtarak të të gjitha institucioneve të saj), lindja dhe krijimi i saj nuk duhet vështruar si kundërpozicion i popullit shqiptar ndaj masave kundërkushtetuese dhe represive të Serbisë në Kosovë. Republika e Kosovës, para së gjithash, bëri realizimin e intencave dhe aspiratave historike të popullit shqiptar për liri dhe pavarësi dhe përcaktimin demokratik të tij, që të jetojnë në mëvetësi me ligjet e veta dhe me organizim të pavarur politik.

### **Aktet burimore kushtetuese dhe politike me të cilat u lind Republika e Kosovës**

Pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë rrethanat politike për Kosovën ndryshuan. Siç e thamë edhe më lart, autonomia dhe pozita që kishte Kosova në kuadër të Kushtetutës së vitit 1974 u rrënuar në mënyrë kundërkushtetuese dhe kundërligjore, në kushtet e dhunës dhe

shtetrrrethimit.<sup>5</sup> Të gjendur në këto rrethana Kosova krijoi institucionet e saj të ashtuquajtura “paralele”, mirëpo të njëjtat institucione përfaqësonin vullnetin e popullit të Kosovës.<sup>6</sup> Po ashtu, në këtë kohë u krijua edhe lëvizja e parë politike e cila mishërohej me përfaqësimin e vullnetit të popullit të Kosovës e cila u quajt Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të cilën e udhëhiqte dr. Ibrahim Rugova.<sup>7</sup> Populli i Kosovës dhe përfaqësuesit e tij, të ndodhur në një situatë të rrënimt të autonomisë dhe të udhëkryqit të vendosjes për fatin e tyre, ndërmorën një numër veprimesh juridike dhe politike duke nxjerrë një numër të caktuar të akteve kushtetuese përmes të cilave transmetonin vullnetin e tyre, duke e krijuar kështu Republikën e Kosovës. Nga kjo që u theksua më lart, rrjedh se Republika e Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur, lindi dhe u krijua me këto akte kryesore kushtetuese dhe politike:

1. Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut të vitit 1990.
2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës e 7 shtatorit të vitit 1990 (Kushtetuta e Kaçanikut).
3. Referendumi gjithëpopullor për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur i mbajtur më 26-30 shtator të vitit 1991.
4. Rezoluta e Kuvendit të Kosovës për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19 tetor 1991.
5. Amendamentet kushtetuese në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të miratuara nga Kuvendi i Kosovës më 19 tetor 1991.<sup>8</sup>
6. Zgjedhjet e lira dhe shumëpartiake për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe për zgjedhjen e kryetarit të

---

<sup>5</sup> Noel Malcolm, *“Kosova një histori e shkurtër”*, Mecmilan, London, 1993, 361-364.

<sup>6</sup> Michael Salla, *“Kosovo, Non-violence and the Break-up of Yugoslavia”*, SAGE publications, vol, 26(4)-427-438, 1995, 428-429.

<sup>7</sup> Po aty, 429-430.

<sup>8</sup> Po aty.

Republikës të mbajtura më 24 maj 1992 dhe për të dytën herë më 22 mars të vitit 1998.<sup>9</sup>

Renditja e akteve dhe veprimeve të lartpërmendura është bërë në mbështetje të kohës së nxjerrjes së tyre, ngase ato paraqesin një proces të pashkëputshëm me të cilin është bërë rumbullakësimi kushtetues dhe politik i Republikës së Kosovës. Këto akte njëherësh mund të cilësohen edhe si akte burimore, përmes të cilave ka lindur dhe është krijuar Republika e Kosovës.

### **Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut 1990**

Menjëherë pas miratimit të amendamenteve kushtetuese (në Kushtetutën e RS të Serbisë të vitit 1974) në vitin 1989, pushteti serb përmes një mori ligjesh dhe akteve të tjera kundërkushtetuese, filloi procesin e deinstitutionalizimit politik të Kosovës. Ky proces kishte për qëllim kryesor krijimin e të ashtuquajturës Serbi unike dhe vënien e Kosovës nën juridiksionin e plotë të saj. Nëpërmjet këtyre masave kundërkushtetuese Kuvendi i Serbisë e shkatërroi tërë sistemin politik, kushtetues, juridik, ekonomik, arsimor, kulturor, informativ dhe segmentet e tjera të jetës në Kosovë.

Me qëllim të ndaljes së këtij procesi kundërkushtetues të shkatërrimit të mëvetësisë së Kosovës, Kuvendi i Kosovës (i konstituuar në zgjedhjet e vitit 1989) bëri përpjekje për kthimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë në Kosovë. Këtu, para së gjithash, veçojmë përpjekjet e këtij organi për ruajtjen e subjektivitetit politik të Kosovës dhe për anulimin e shumë akteve dhe veprimeve kundërkushtetuese të Kuvendit të Serbisë me të cilat u bënë integritet të dhunshme të ekonomisë së Kosovës me atë të Serbisë, si dhe plaçkitja e ekonomisë së Kosovës. Në anën tjetër, orvatjet e Kuvendit të Kosovës ishin të orientuara edhe në drejtim të anulimit të ligjeve të tjera të Kuvendit të Serbisë, me të cilat u morën autorizimet e

---

<sup>9</sup> Arsim Bajrami, “Aktet kushtetuese dhe politike të shtetësisë së Kosovës”, Prishtinë 1996, 24-41.

organeve të Kosovës, dhe ato u bartën në organet republikane të Serbisë. Kjo periudhë, pra nga viti 1989 nga disa autorë konsiderohet si periudhë e nënshtrimit të Kosovës<sup>10</sup>.

Veprimi i këtillë i Kuvendit të Kosovës u bë pengesë për realizimin e konceptit nacionalist mbi “Serbinë unike”, i cili u proklamua me Kushtetutën e Serbisë të vitit 1990. Me qëllim të evitimit të kësaj pengese, pushteti serb nëpërmjet kryetarit të Kuvendit të Kosovës, filloi obstrukcionin e punës së Kuvendit legjitim të Kosovës. Ky obstrukcion posaçërisht shprehej në mosçaktivimin e mbledhjeve të Kuvendit, ndërprerjet e paarsyeshme të punës së tij, e deri te mbyllja e ndërtesës së Kuvendit të Kosovës nga ana e forcave policore dhe moslejimin e delegatëve shqiptarë që të mbajnë mbledhje<sup>11</sup>. Në këtë periudhë, në hapësirën jugosllave aktualisht zhvilloheshin bisedimet politike rreth ripërkufizimit të Jugosllavisë në formë të Federatës (koncepti serbo-malazias) apo Konfederatës (koncepti slloveno-kroat).

Në këto bisedime, në mënyrë kundërkushtetuese ishin përjashtuar shqiptarët dhe organet legjitime të Kosovës, edhe pse Kosova sipas Kushtetutës së RSFJ-së të vitit 1974 kishte të drejtë pjesëmarrjeje të barabartë në procesin e vendosjes politike lidhur me ardhmërinë e Jugosllavisë. Të ballafaquar me një situatë të tillë, kur pushteti serb haptazi suprimoi institucionin kryesor politik - Kuvendin e Kosovës dhe kur shqiptarët dhe Kosova në mënyrë kundërkushtetuese u përjashtuan nga bisedimet për rregullimin e ardhshëm të Jugosllavisë, 111 delegatët e Kuvendit të Kosovës, më 2 korrik të vitit 1990, para platosë së ndërtesës së Kuvendit miratuan dhe publikisht shpallën Deklaratën kushtetuese me të cilën deklarohet pozita e re kushtetuese e Kosovës.<sup>12</sup> Në mbështetje të së drejtës sovrane të popullit të Kosovës, duke përfshirë këtu edhe të drejtën e

<sup>10</sup> Oliver Jens Schmitt, “Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike”, botimet “Koha”, Prishtinë, Nëntor 2012, 242-245.

<sup>11</sup> Arsim Bajrami, “Aktet kushtetuese dhe politike të shtetësisë së Kosovës”, Prishtinë 1996, 24-41.

<sup>12</sup> Teksti origjinal, deklarata kushtetuese e lexuar në Kuvendin e Kosovës, 2 korrik 1990.

vetëvendosjes dhe duke u nisur nga vullneti i shfaqur vendosmërisht anëmbanë Kosovës nga pjesa dërmuese e popullatës së Kosovës, e sublimuar edhe në Deklaratën e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, me Deklaratën Kushtetuese, Kosova shpallet njësi e pavarur dhe e barabartë në kuadër të Federatës përkatësisht Konfederatës së Jugosllavisë, si subjekt i barabartë me njësitë e tjera federale në Federatë, përkatësisht Konfederatë. Duke miratuar Deklaratën Kushtetuese, Kuvendi i Kosovës, si Kuvend legjitim dhe legal në kuadrin e strukturës së atëhershme të federalizmit multinacional të Jugosllavisë, vendosi për barazinë e Kosovës me njësitë e tjera federale të Jugosllavisë në kuadër të Federatës apo Konfederatës. Vështruar nga këndi historik, Deklarata Kushtetuese, riafirmoi përcaktimin politik të popullit shqiptar për vetëvendosje të shprehur që në Rezolutën e Konferencës së Bujanit. Me këtë Deklaratë kushtetuese të karakterit konstitutiv politik, përveç të tjerash “*ispo jure*” u bë derogimi i Rezolutës së Kuvendit të Prizrenit të vitit 1945 mbi bashkimin e Kosovës “Serbisë federale”. *Leges posteriores priores contrarias abrogant (Ligji i mëvonshëm anulon marrëveshjen e mëhershme)*.

Në favor të këtij argumenti të saktë shkencor, duhen theksuar këto dy fakte:

1. Në Rezolutën e Kuvendit kontestues të mbajtur në Prizren më 8, 9 dhe 10 korrik të vitit 1945, konfirmohet se Kosova “në bazë të dëshirës së popullit të saj vendosi t’i bashkohet Serbisë federale”. Nga ky formulim, që jepet në këtë Rezolutë, vërtetohet bashkimi vullnetar i Kosovës me Serbinë federale në kuadër të Jugosllavisë Federative.

2. Hyrja “vullnetare” e Kosovës në kuadër të Serbisë nuk e konsumon të drejtën e saj që të shpëputet nga kjo lidhje me Serbinë, pas shpërbërjes së ish-RSFJ-së, në kushtet kur populli shumicë i Kosovës deklarohet me metoda demokratike për sovranitet dhe pavarësi të saj. Në këtë drejtim, pas ndërrimit të rrethanave politike, në sajë të procesit të shpërbërjes së Federatës Jugosllave, populli shqiptar artikuloi vullnetin e vet politik në Deklaratën Kushtetuese me

të cilën Kosova u përcaktua njësi sovrane dhe e pavarur.

Deklarata Kushtetuese është, në thelb, një akt politik që përmban edhe qëndrimin juridik dhe vendimin e Kuvendit të Kosovës, me të cilin anulohet vendimi i tij i mëparshëm për dhënien e pëlqimit për amendamentet kushtetuese në Kushtetutën e RS të Serbisë (23 mars 1989), që madje as që ekzistonte. Vështruar nga aspekti kushtetues, Deklarata paraqet akt konstitutiv me të cilin bëhet avancimi i pozitës kushtetuese të Kosovës nga njësi autonome në njësi të pavarur dhe të barabartë me njësitë e tjera federale të ish-Jugosllavisë. Teksti i Deklaratës është mjaft i shkurtër, dhe ai, përpos preambulës së shkurtër, përmban gjashtë pika.

Në pikën e parë të Deklaratës jepet konstatimi se përmes saj shfaqet dhe shpallet vullneti burimor kushtetues i popullatës kosovare dhe i Kuvendit, si akt i vetëvendosjes së tij politike në kuadër të Jugosllavisë.

Në pikën e dytë, në mbështetje të parimit të demokracisë autentike mbi respektimin e vullnetit të njerëzve dhe të kolektiviteteve njerëzore e nacionale, Kuvendi i Kosovës pret përkufizimin e këtij akti konstitutiv në Kushtetutën e Jugosllavisë dhe pranimin e tij nga ana e opinionit demokratik jugosllav dhe atij ndërkombëtar.

Pika 3 e Deklaratës bën avancimin e popullit shqiptar, si popull shumicë dhe njërin prej popujve numerikisht më të mëdhenj të Jugosllavisë nga pozita e kombësisë (pakicë kombëtare) në komb të barabartë me kombet e tjera të ish-Jugosllavisë.<sup>13</sup> Anulimi, përkatësisht shfuqizimi i vendimit të Kuvendit të Kosovës, për dhënien e pëlqimit në amendamentet kushtetuese në Kushtetutën e RS të Serbisë të vitit 1989, bëhet në pikën 4<sup>14</sup> të Deklaratës, ku theksohet se deri në zbatimin përfundimtar juridik të kësaj Deklarate Kushtetuese, Kuvendi dhe organet e pushtetit të Kosovës, raportet e veta në rregullimin kushtetues të Jugosllavisë, i mbështetin në

<sup>13</sup> Teksti origjinal, Deklarata kushtetuese e lexuar në Kuvendin e Kosovës, 2 korrik 1990, pika 3.

<sup>14</sup> Po aty, pika 4.

Kushtetutën e RSFJ-së të vitit 1974. Në pikën 5<sup>15</sup> Kuvendi i Kosovës shpreh mospranimin e emërtimit serb të Kosovës dhe orientimin e tij që publikisht të komunikojë vetëm me emrin Kosovë. Dhe në fund, në pikën 6 thuhet se Deklarata hynë në fuqi ditën e miratimit të saj.

### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës e 7 shtatorit 1990 (Kushtetuta e Kaçanikut)**

Duke u nisur nga e drejta e vetëvendosjes, duke respektuar vullnetin sovran të popullit shqiptar, të shprehur në mënyrë plebishitare në tërë Kosovën, lidhur me subjektivitetin politik dhe juridik, të Kosovës, e më qëllim të materializimit kushtetues të Deklaratës Kushtetuese të 2 korrikut të vitit 1990, Kuvendi i Kosovës, në mbledhjen e përbashkët të tri dhomave të tij, mbajtur më 7 shtator vitit 1990, në Kaçanik, aprovoi dhe shpalli Kushtetutën e Republikës së Kosovës me të gjitha dokumentet përcjellëse dhe nxori Ligjin për zgjedhjet, si dhe disa vendime të tjera të nevojshme për punën e Kuvendit të Kosovës dhe marrjen e vendimit në Kuvendin e RSFJ-së.<sup>16</sup>

Kjo Kushtetutë e Republikës së Kosovës përbën një akt historik, me të cilin populli shqiptar realizoi aspiratat e veta historike, të cilat gjatë pesë dekadave të kaluara u ndëshkuan dhe u inkriminuan nga pushteti serb dhe ai jugosllav. Nxjerrja e kësaj Kushtetute shënoi kurorëzimin e kërkesave legjitime, të cilat në skenën politike jugosllave filluan të artikulohej në demonstratat masive të shqiptarëve të viteve 1968 dhe 1981, ku kërkesë parësore dhe dominante politike ishte konstituimi i Kosovës republikë me të drejta të barabarta me republikat e tjera të ish-Jugosllavisë. Për dallim nga Kushtetuta e KSA të Kosovës<sup>17</sup> e vitit 1974, Kushtetuta e Republikës së Kosovës e

<sup>15</sup> Po aty, pika 5.

<sup>16</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 7 shtator 1990.

<sup>17</sup> Kushtetuta e KSA të Kosovës 1974 (botime "Rilindja" 1974) kishte 402 nene dhe dallonte substancialisht për nga statusi i Kosovës, i cili ishte rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, 1990.

7 shtatorit të vitit 1990<sup>18</sup> përmban një tekst mjaft të shkurtër, i cili përcakton organizim krejtësisht të pavarur politik dhe kushtetues të Kosovës. Duke u shërbyer me zgjidhjet pozitive dhe kushtetuese dhe me përvojat e shteteve demokratike të Evropës dhe botës, me Kushtetutën e Kaçanikut konstituohet aso forme e rregullimit shtetëror të mbështetur në sovranitetin e popullit dhe të qytetarëve, lirinë e organizimit dhe veprimit politik të qytetarëve, pluralizmin e formave të pronës, ekonomisë së tregut dhe kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë si bazë e sistemit kushtetues dhe politik.<sup>19</sup>

## **Referendumi për pavarësinë e Kosovës**

Pas nxjerrjes së Kushtetutës së Kosovës në vitin 1990, jetën politike në Kosovë e karakterizoi radikalizmi i dhunës serbe në të gjitha sferat e jetës. Në sajë të veprimit kundërkushtetues, e duke përdorur metodat e okupimit policor, pushteti serb shkatërroi ekonominë kosovare, shëndetësinë, arsimin në të gjitha nivelet, institucionet kulturore dhe informative e mbi të gjitha bëri largimin masiv nga puna të punëtorëve shqiptarë të punësuar në këto institucione.<sup>20</sup> Ndërkohë, në truallin e ish-Jugosllavisë, si pasojë e dështimit të bisedave politike rreth përkufizimit të Federatës, filloi procesi i shpërbërjes së saj, që u realizua nëpërmjet shpalljes së pavarësisë së katër njëjive federale, të cilat me referendume miratuan deklaratat për pavarësi dhe sovranitet të tyre. Duke u inkorporuar në këto procese demokratike, Kuvendi i Kosovës në shtator të vitit 1990, miratoi Rezolutën për Republikën e Kosovës, shtet i pavarur dhe sovran dhe mori vendim që të mbahet referendumi popullor lidhur me këtë Rezolutë.

<sup>18</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 7 shtator 1990 kishte 140 nene.

<sup>19</sup> Arsim Bajrami, “Aktet kushtetuese dhe politike të shtetësisë së Kosovës”, Prishtinë 1996, 24-41.

<sup>20</sup> Stefan Wolff, “The Kosovo Conflict”, 4, i qasshëm në:

<http://www.stefanwolff.com/files/kosovo.pdf>, qasur së fundmi më 06.07.2017.

Ky referendum u mbajt në Kosovë më 26-30 shtator 1991 dhe në të me shumicë absolute (mbi 99% të zgjedhësve nga 87% të trupit elektoral që votoi në referendum) u deklarua për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur. Referendumi popullor për Kosovën shtet i pavarur dhe sovran<sup>21</sup>, është një akt i vetëpërcaktimit demokratik, politik të popullit shqiptar lidhur me statusin kushtetues dhe politik të Kosovës pas shpërbërjes së Federatës Jugosllave. Duke përkrahur konceptin për Republikën e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran, populli shqiptar në mënyrë demokratike u deklarua për liri, pavarësi dhe sovranitet të plotë të Kosovës. Së këndejmi, mund të përfundojmë se ky referendum është një akt legjitim i deklarimit politik të popullit shqiptar, i cili, sikur popujt e tjerë të Jugosllavisë u inkorporua në proceset e reja demokratike, që secilit popull (pra edhe atij shqiptar) i krijuan kushte për realizimin e së drejtës për vetëvendosje.

Duke u mbështetur në rezultatet e referendumit të mbajtur në Kosovë, Kuvendi i Kosovës më 19 tetor të vitit 1991 shpalli Rezolutën për Republikën e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran. Me këtë Rezolutë konfirmohet deklarimi pozitiv i popullit shqiptar lidhur me sovranitetin dhe pavarësinë e Kosovës. Rezoluta, në thelb, është një akt politik, me të cilin konstatohet sovraniteti dhe pavarësia e Kosovës, si dhe shkëputja e kontinuitetit kushtetues të Republikës së Kosovës me ish-Jugosllavinë. Nxjerrja e kësaj Rezolute është rrjedhojë logjike e procesit të dekompozimit të Federatës Jugosllave dhe e krijimit të shteteve të reja në truallin e saj. Rezoluta të ngjashme më parë nxorën republikat e tjera, si: Sllovenia, Kroacia, Bosnjë-Hercegovina dhe Maqedonia. Në kushte kur nga Federata Jugosllave u shkëputën katër njësi federale, mbetja e Kosovës në Federatën e cinguar me Serbinë dhe Malin e Zi ka qenë e papranueshme dhe e paqëndrueshme. Hyrja eventuale e Kosovës në kuadër të kësaj krijese

---

<sup>21</sup> Cristian Jura, “Kosovo - History and Actuality” AGORA International Journal of Juridical Sciences, [www.juridicaljournal.univagora.ro](http://www.juridicaljournal.univagora.ro) ISSN 1843-570X, E-ISSN 2067-7677 No. 3 (2013), 78-84, 81.

artificiale, qoftë edhe me status të Republikës, nuk ishte zgjidhje e pranueshme për popullin shqiptar, ngase ai në kushtet e Federatës së cunuar në çdo kohë i nënshtrohet majorizimit dhe politikës hegjemoniste serbe. Duke u nisur nga kjo, përcaktimi i Rezolutës për Republikën e Kosovës shtet sovran dhe i pavarur, me pozitë neutrale dhe të hapur (ndaj Serbisë dhe Shqipërisë) ishte opsion real, që bën të mundshëm prosperitetin kombëtar të popullit shqiptar. Ky opsion gjithnjë e më shumë po bëhet pjesë e pandashme e vetëdijes kombëtare të popullit shqiptar, i cili të gjitha aspiratat e veta politike i lidh me sovranitetin dhe pavarësinë e plotë të Kosovës.

### **Amendamentet kushtetuese në Kushtetutën e Republikës së Kosovës 1991**

Miratimi i Rezolutës për Republikën e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran krijoi një gjendje të re konstitucionale, e cila kërkon ndryshime dhe plotësime adekuate në Kushtetutën e Republikës së Kosovës të 7 shtatorit të vitit 1990. Në këtë drejtim, Kuvendi i Kosovës, më 19 tetor të vitit 1991 miratoi amendamentin I dhe amendamentet II-VI, me të cilat bëri ndryshimin e dispozitave adekuate të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Meqenëse këto amendamente përcaktojnë zgjidhje të reja kushtetuese, në këtë rast, shkurtimisht do ta analizojmë përmbajtjen e tyre.<sup>22</sup>

Me amendamentin I Republika e Kosovës u shpall shtet sovran dhe i pavarur. Me këtë përcaktim ndryshohet neni 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili supozonte qenien e Kosovës në kuadër të bashkësisë jugosllave. Duke u nisur nga ky ndryshim, ky amendament ka karakter konstitutiv, ngase sanksionon zgjidhje të re kushtetuese të pozitës së Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur dhe shkëputjen e saj nga ish-Jugosllavia. Amendamenti II aplikonte institucionin e kryetarit të Republikës si shef individual i shtetit, i cili merr të gjitha kompetencat e caktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

---

<sup>22</sup> Amendamentet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës 1990 I-VI.

Në amendamentin III përcaktohen funksionet e kryetarit të Republikës. Sipas këtij amendamenti, kryetari i Republikës përfaqëson Republikën e Kosovës në vend dhe në botë dhe është komandant suprem i forcave të armatosura të saj. Krahas funksioneve të mëparshme që i kishte Kryesia e Kosovës, në pikat 6, 7, 8, 9 dhe 11 të këtij amendamenti përcakton funksionet e reja të kryetarit të Republikës. Në alinenë e dytë të këtij amendamenti përcaktohen dispozitat e reja për mbrojtjen e Republikës, gjendjen e luftës dhe gjendjen e jashtëzakonshme. Amendamenti IV përcaktonte kushtet dhe procedurën për zgjedhjen e kryetarit të Republikës.

Sipas këtij amendamenti, kryetarin e Republikës e zgjedhin qytetarët e Republikës në zgjedhjet e lira, drejtpërsëdrejti me vota të fshehta, në pajtim me ligjin. Në pikën 5 të këtij amendamenti përcaktohet se, në rastet kur ekziston gjendje lufte apo gjendje e jashtëzakonshme, Qeveria, në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin, miraton dekrete me fuqi ligjore. Autorizimi i Qeverisë për të miratuar dekrete me fuqi ligjore zgjat derisa të përfundojë gjendja e luftës apo gjendja e jashtëzakonshme, dhe për këtë vendos Kuvendi. Kjo zgjidhje kushtetuese ka pasur për qëllim që autorizimet e Kuvendit të Kosovës (për shkak të moskonstituimit të tij) gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme t'i bartë në Qeverinë e Kosovës, e cila autorizohet që të miratojë dekrete me fuqi ligjore. Amendamentet V dhe VI kryesisht kishin karakter teknik, sepse përcaktojnë zgjidhje teknike që kanë të bëjnë me zëvendësimin e shprehjes “Kryesia e Republikës”, me shprehjen “Kryetari i Republikës”, si dhe përcaktojnë se për zbatimin e amendamenteve II-V do të nxirret Ligji i veçantë kushtetues.<sup>23</sup>

---

<sup>23</sup> Arsim Bajrami, “Aktet kushtetuese dhe politike të shtetësisë së Kosovës”, Prishtinë 1996, 39.

## Zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale 1992-1998

Pas miratimit të amendamenteve kushtetuese në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, u krijua baza kushtetuese për mbajtjen e zgjedhjeve të para demokratike, të lira dhe shumëpartiake për zgjedhjen e Kuvendit të Kosovës dhe kryetarit të Republikës. Këto zgjedhje u mbajtën më 24 maj të vitit 1992,<sup>24</sup> me pjesëmarrjen masive të popullit shqiptar, i cili për herë të parë kishte mundësinë e deklaratimit të lirë për zgjedhjet e organeve kryesore të Republikës së Kosovës. Në këto zgjedhje, në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin mbi zgjedhjet, u zgjodhën 130 deputetë për Kuvendin e Kosovës, si edhe u zgjodh kryetari i Republikës. Në pajtim me Ligjin për zgjedhjet, kandidatët për deputetë të Kuvendit të Kosovës i propozuan partitë politike, lëvizjet politike, shoqatat e qytetarëve dhe subjektet e tjera të përcaktuara me këtë ligj.

Meqenëse ky ligj zbaton kombinimin e parimit të shumicës me parimin proporcional, në këto zgjedhje nga 130 deputetë sa ka Kuvendi i Kosovës, u zgjodhën 100 në bazë të rezultateve zgjedhore, kurse 30 të tjerë do të zgjidhen më vonë sipas parimit të përfaqësimit proporcional të partive politike që kanë fituar përqindje të caktuar të votave të trupit elektoral dhe përfaqësimit adekuat të partive politike që tubojnë pakicat kombëtare që jetojnë në Republikën e Kosovës. Zgjedhja e kryetarit të Republikës u bë në mënyrë demokratike, me votim të fshehtë. Cikli i dytë i zgjedhjeve parlamentare në kushtet e okupimit serb dhe në kohën kur konflikti i armatosur në mes të UÇK-së dhe forcave serbe kishte filluar në Drenicë, u mbajtën më 22 mars të vitit 1998, me ç'rast u zgjodh Kuvendi i Kosovës dhe kryetari i Kosovës. Mirëpo, si edhe në rastin e zgjedhjeve të vitit 1992, pas këtyre zgjedhjeve, nuk pasoi konstituimi i organeve dhe funksionimi i tyre sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës të vitit 1990.<sup>25</sup>

<sup>24</sup> Stefan Troebst, “*Conflict in Kosovo: Failure of Prevention? An Analytical Documentation, 1992-1998*”, European Centre for Minority Issues (ECMI) Flensburg 1998, 31-32.

<sup>25</sup> Arsim Bajrami, “*Aktet kushtetuese dhe politike të shtetësisë së Kosovës*”, Prishtinë 1996,

## **Okupimi i Kosovës dhe eskalimi i luftës së armatosur<sup>26</sup>**

Pas shpalljes së Republikës së Kosovës, Serbia intensifikoi dhunën shtetërore ndaj shqiptarëve, duke zbatuar politikën e saj të shtypjes, keqtrajtimit, të shkeljes së të drejtave elementare (përfshirë këtu edhe të drejtën për jetë) dhe një arsenal të tërë të dhunës shtetërore që synonte spastrimin etnik dhe vënien e plotë të Kosovës nën juridiksionin serb. Pas vitit 1990, Serbia përmes metodës së puçit kushtetues shkatërroi të gjitha institucionet legjitime të Kosovës dhe me ndihmën e dhunës policore, okupoi të gjitha institucionet publike në Kosovë, që nga ato politike, arsimore, kulturore, informative, shëndetësore, sportive etj.<sup>27</sup>

Praktikisht, shqiptarët dhe Kosova, përmes një varg ligjesh diskriminuese, vendosën në gjendje jashtëligjore dhe Serbia zbatoi një segregacion etnik në shkallë apartheidi, duke kufizuar dhe shkelur të gjitha liritë individuale dhe politike, duke siguruar sundimin e pakicës serbe ndaj shumicës shqiptare. Si përgjigje ndaj dhunës serbe, shqiptarët zgjodhën rrugën e jodhunës dhe përmes mjeteve politike shprehën kundërshtimin e okupimit serb dhe padëgjueshmërinë qytetare ndaj këtij okupimi. Ata, nuk morën pjesë në zgjedhjet serbe dhe jugosllave dhe nuk participuan në asnjë proces politik, të cilin Serbia dhunshëm e imponoi në Kosovë. Në anën tjetër, shqiptarët në Kosovë bënë përpjekje për organizim paralel të institucioneve politike, arsimore, kulturore, informative etj. Në periudhën deri në eskalimin e plotë të luftës në Kosovë, siç u tha, u mbajtën dy cikle të zgjedhjeve parlamentare, por mungoi funksionalizimi i organeve të Kosovës. Këtë e pengoi regjimi serb, i cili ndëshkonte dhe

---

41.

<sup>26</sup> Shih më shumë edhe: Dusan Janjić, with Anna Lalaj and Besnik Pula “*Kosovo under the Milošević Regime*”, 272-301. Publikuar në kuadër të: “*Confronting the Yugoslav Controversies*” United States Institute of Peace Press Washington, D.C., 2009, Purdue University.

<sup>27</sup> Peter Hilpold, “*The International Court of Justice’s Advisory Opinion on Kosovo: Perspectives of a Delicate Question*”, *Austrian Review of International and European Law*, 264-266.

pamundësonte çdo përpjekje të shqiptarëve për organizim shtetëror, por edhe mungesa e një strategjie të qartë politike të subjekteve të atëhershme politike për realizimin e përcaktimit politik të popullit të Kosovës për pavarësi, me referendumin e vitit 1991.<sup>28</sup>

### **Paraqitja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës**

Duke mos u pajtuar me okupimin serb të Kosovës dhe duke parë paaftësinë e zgjidhjes politike të krizës në Kosovë, pas vitit 1990, filluan përgatitjet për formimin e UÇK-së, si formacion i rregullt ushtarak dhe si kryengritje e armatosur për çlirimin e Kosovës. Këto përgatitje u kurorëzuan në vitin 1997, kur UÇK-ja doli publikisht në skenë dhe filloi luftën çlirimtare në Kosovë. Formimi i UÇK-së paraqet një ngjarje historike për popullin e saj, në luftën e tij historike për pavarësi. Formimi i UÇK-së<sup>29</sup> bazohej në vetë Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të 7 shtatorit të vitit 1990, e cila në nenin 77 shprehimisht përcaktonte se: “mbrojtja e vendit, është e drejtë e pacenueshme dhe e patjetërsueshme, obligim dhe nder i madh i çdo qytetari”. Themelimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, bëri që të krijohen raporte të reja në Kosovë dhe rajon, që problemi i Kosovës të dalë në skenë me tërë kompleksitetin e tij. Kundërvënia e armatosur e shqiptarëve, përmes UÇK-së, ishte një dëshmi e fuqishme e gatishmërisë së popullit të Kosovës, që me vetëflim dhe sakrificë, të dëshmojë përcaktimin e tij të fuqishëm për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Ky fakt bëri që problemi i Kosovës të arrijë kulminacionin e ndërkombëtarizimit dhe të marrë një trajtim më adekuat. Në të vërtetë, fillimi i luftës çlirimtare nga UÇK-ja nxori në shesh faktin se çështja e

---

<sup>28</sup> Stefan Troebst, “*Conflict in Kosovo: Failure of Prevention? An Analytical Documentation, 1992-1998*”, European Centre for Minority Issues (ECMI) Flensburg, 1998, 31.

<sup>29</sup> Peter Hilpold, “*The International Court of Justice’s Advisory Opinion on Kosovo: Perspectives of a Delicate Question*”, Austrian Review of International and European Law, 264.

Kosovës nuk paraqet çështje të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të shqiptarëve (siç trajtohej deri atëherë ky problem), por një problem politik në thelbin e së cilës është e drejta e vetëvendosjes së shqiptarëve, përkatësisht pavarësia e Kosovës. E formuar nga motivi çlirimtar, UÇK-ja arriti shumë shpejt të fitojë mbështetjen e popullit të Kosovës dhe të paraqitet si faktor kryesor në komunikimet me faktorin ndërkombëtar rreth zgjidhjes së krizës në Kosovë. Në doktrinën ushtarake ndërkombëtare, UÇK-ja paraqet formacionin ushtarak i cili gëzoi njohje shumë të shpejtë ndërkombëtare.<sup>30</sup>

Që nga ditët e para të paraqitjes publike, filluan kontaktet diplomatike të UÇK-së me diplomatët e huaj, sidomos të atyre amerikanë rreth zgjidhjes së krizës. Në këto kontakte u bë njohja *de facto* e UÇK-së, kurse njohja *de jure* e saj, pasoi në Konferencën e Rambujesë, ku përfaqësuesit e saj u legjitimuan si negociatorë kryesorë, kurse ish-udhëheqësi i Drejtorisë Politike të UÇK-së, njëkohësisht kryeson delegacionin kosovar në këtë Konferencë.

E formuar fillimisht përmes njërive të vogla guerile, UÇK-ja shumë shpejt mori formën e një ushtrie të rregullt me një strategji të qartë politike, me një komandim unik dhe me strukturë tipike ushtarake. Ajo arriti të çlirojë shumë territore të Kosovës dhe të përfitojë simpatinë ndërkombëtare për luftën e drejtë të saj. Në anën tjetër, policia dhe ushtria serbe, si dhe formacionet e saj paramilitare, duke mos qenë në gjendje të mposhtin UÇK-në, vazhduan vrasjen joselektive të civilëve shqiptarë, masakrimin e tyre kolektiv, djegien e shtëpive dhe pasurisë së tyre, si dhe deportimin e tyre të dhunshëm jashtë Kosovës. Ky deportim, pas dështimit të Konferencës së Rambujesë, mori trajtën e një eksodi masiv, me synim të spastrimit etnik dhe gjenocidit të shqiptarëve. Më tepër se 1 milion shqiptarë të Kosovës u dëbuan dhunshëm nga policia serbe në Maqedoni, Shqipëri dhe anembanë Evropës. Ky eksod masiv, dhuna dhe gjenocidi, të cilën Serbia e ushtroi në Kosovë, si dhe lufta e drejtë e UÇK-së, zgjoi ndërgjegjen e komunitetit ndërkombëtar dhe nevojën e ndërhyrjes

---

<sup>30</sup> Greg Campbell, "The road to Kosovo", 2000, 159-181.

ushtarake kundër Serbisë. Kjo edhe ndodhi, më dt. 24.03.1999, kur NATO-ja filloi luftën kundër Serbisë, luftë që zgjati 78 ditë dhe përfundoi me kapitullimin e Serbisë dhe tërheqjen e saj të plotë nga territori i Kosovës. Pas përfundimit të luftës dhe vendosjes së Kosovës nën prezencën civile dhe ushtarake ndërkombëtare dhe marrjes përsipër të sigurisë së Kosovës nga forcat e KFOR-it, erdhi deri te demilitarizimi i UÇK-së, dhe formimi i Trupave Mbrojtëse të Kosovës-TMK.

### **Konferenca e Rambujesë, aspekti juridik dhe ndërkombëtar**

Gjenocidi serb në Kosovë, i cili manifestohej në forma të ndryshme të dhunës dhe masakrimit të shqiptarëve, riktheu interesimin e komunitetit ndërkombëtar në Kosovë dhe nevojën e pashlyeshme për një zgjidhje të shpejtë politike të konfliktit. Në këtë kontekst, masakra e Reçakut dhe gjykimi i drejtë i saj, nga ambasadori i OSBE-së në Kosovë, Uoker, ishte ngjarje kyçe, e cila ndikoi në thirrjen e një Konference paqësore ndërkombëtare për Kosovën, në Rambuje të Francës. Konferenca ndërkombëtare paqësore për Kosovën u mbajt në Rambuje dhe Paris prej 6 deri me 23 shkurt dhe prej 15 deri më 18 mars 1999, në kohën kur kriza në Kosovë kishte përshkallëzuar në një luftë të përgjakshme me rrezik për t'u shtrirë edhe jashtë kufijve të Kosovës.

Konferenca paraqiste përpjekjen e fundit politike për ndaljen e luftës dhe gjenocidit serb kundër shqiptarëve, vendosjen e Kosovës nën protektoratin e NATO-s, krijimin e një statusi kalimtar për Kosovën dhe evitimin e rrezikut potencial që kërcënonte paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Konferenca ishte organizuar nga i ashtuquajti Grup i Kontaktit dhe në Konferencë mori pjesë delegacioni shqiptar, ai serbo-jugosllav dhe pala ndërkombëtare, ku bënë pjesë anëtarët e Grupit të Kontaktit dhe shumë shtete evropiane. Delegacioni shqiptar përfaqësohej nga subjektet e atëhershme politike dhe përfaqësuesit e UÇK-së, si dhe nga ekspertët e pavarur. Delegacioni serbo-jugosllav përfaqësohej nga zyrtarët e lartë serbë

dhe nga anëtarët lojalë të politikës së regjimit serb. Konferenca kryesohej nga tre bashkëkryesues Kristofer Hill nga SHBA-ja, Volfang Petriq nga Këshilli i Evropës dhe Boris Majorski nga Federata Ruse.<sup>31</sup>

Procesi negociator në Rambuje zhvillohej mbi bazën e Projektmarrëveshjes së Rambujesë, përkatësisht Projektmarrëveshjes së Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë, të cilën e kishte përgatitur Grupi i Kontaktit. Konferenca e Rambujesë synonte arritjen e një marrëveshjeje juridike dhe politike për zgjidhjen e krizës në Kosovë, duke përcaktuar një zgjidhje kalimtare që parashihte vendosjen e Kosovës nën mbrojtjen e NATO-s, të mundësonte një vetadministrim të përkohshëm për Kosovën në periudhën trevjeçare dhe të hapte mundësinë e zhvillimit të një procesi politik për përcaktimin e statusit final për Kosovën. Konferenca parashihte një proces negociues të palës shqiptare dhe serbe për marrëveshjen politike, të cilën e propozonin ndërmjetësuesit ndërkombëtarë. Me gjithë përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar, në këtë Konferencë nuk kishte kontakte të drejtpërdrejta shqiptaro-serbe, për shkak të refuzimit të delegacionit shqiptar për t'u takuar me palën serbe.

Në Konferencë dominonin dy qasje dhe koncepte. Qasja e delegacionit shqiptar, që ishte konstruktive dhe kooperative me faktorin ndërkombëtar dhe qasja e dytë serbe destruktive dhe joserioze, e cila bënte obstrukcion në arritjen e kësaj marrëveshjeje dhe përjashtonte çdo opsion të ndarjes së Kosovës nga Serbia dhe të vendosjes së saj nën administrimin ndërkombëtar. Konferenca, krahas negociatorëve politikë ndërkombëtarë udhëhiqej dhe përgatitej nga ekspertët amerikanë, të cilët ishin hartues të të gjitha drafteve që diskutoheshin në Konferencë. Në fund të pjesës së parë të Konferencës në Rambuje, në punimet e saj u inkuadrua në mënyrë aktive edhe zonja Madeleine Albright (Medlin Olbrajt), Sekretare e Jashtme e Shtetit amerikan, e cila i ofroi ndihmë të konsiderueshme

---

<sup>31</sup> Stephen T. Hosmer, *“Why Milosevic Decided to Settle when He Did”*, Prepared for the United States Air Force, 2001, 8-16.

delegacionit kosovar. Në pjesën e parë të punës së kësaj Konference, delegacioni kosovar përkrahu në parim tekstin e marrëveshjes së propozuar nga negociatorët ndërkombëtarë dhe kërkoi që nënshkrimin e saj ta bëjë pas një konsultimi të sërishëm me popullin në Kosovë. Ndërkaq, pala serbe refuzoi në tërësi marrëveshjen, duke mos treguar seriozitet në negociata dhe duke refuzuar çdo zgjidhje politike të krizës.

Në pjesën e dytë të Konferencës në Paris, delegacioni kosovar bëri nënshkrimin solemn të Marrëveshjes, kurse ai serb sërish refuzoi nënshkrimin e saj. Marrëveshja u nënshkrua edhe nga tre ndërmjetësuesit ndërkombëtarë. Teksti i Marrëveshjes përbëhej nga marrëveshja bazë e quajtur Marrëveshje e Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë dhe tetë kaptina (anekse) kryesore. Në fund të tekstit të Marrëveshjes së Rambujesë, me insistimin e delegacionit kosovar, është dhënë një klauzolë e veçantë në të cilën shprehimisht përcaktohet se “tre vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, do të thirret një mbledhje ndërkombëtare për të determinuar një mekanizëm për një vendosje (zgjidhje) finale për Kosovën në bazë të vullnetit të popullit, të mendimeve të autoriteteve relevante, të përpjekjeve të secilës palë në lidhje me implementimin e kësaj Marrëveshjeje dhe të Aktit Final të Helsinkit dhe do të ndërmerren vlerësimet e përgjithshme mbi implementimin e kësaj marrëveshjeje, duke i konsideruar propozimet nga secila palë për masat shtesë”.

Edhe pse nga ky formulim nuk përcaktohet shprehimisht e drejta e mbajtjes së referendumit me rastin e zgjidhjes finale të statusit të Kosovës, mendojmë se ky formulim ishte një bazë e mjaftueshme juridike për mbajtjen e tij, pas kalimit të periudhës trevjeçare, sa edhe parashihej vlefshmëria e Marrëveshjes së Rambujesë. Kjo aq më parë, kur si garanci shtesë për mbajtjen e referendumit, zonja M. Albright (M. Olbrajt) kishte deponuar me shkrim garancinë në të cilin konstatohet se propozimi për shprehjen e vullnetit të popullit paraqet një konfirmim të së drejtës së popullit të Kosovës për të mbajtur një Referendum për statusin final të Kosovës pas tre vjetësh. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Rambujesë nga delegacioni kosovar ka qenë një akt

pragmatik, i cili mundësoi ndërhyrjen ushtarake të NATO-s në Kosovë dhe çlirimin e territorit të saj. Mirëpo, vështruar nga aspekti i legalitetit, kjo Marrëveshje është e paqëndrueshme, ngase ajo nuk është akceptuar dhe nënshkruar nga pala serbe. Kjo është me rëndësi të theksohet, sepse Rezoluta 1244 i referohet kësaj Marrëveshjeje dhe parimeve të saj, si bazë për statusin politik të Kosovës. Një referim i tillë, është plotësisht i paqëndrueshëm, jo vetëm nga aspekti juridik, por edhe aspekti politik.

### **Ndërhyrja e NATO-s dhe çlirimi i territorit të Kosovës**

Pas dështimit të Konferencës në Rambuje filluan përgatitjet intensive të NATO-s për fillimin e aksioneve ushtarake kundër Serbisë, në bazë të planit të përgatitur më herët dhe të aprovuar nga NATO-ja. Këto bombardime ajrore filluan më 24.03.1999 dhe zgjatën plot 78 ditë, për të rezultuar me fitoren e plotë të NATO-s dhe kapitullimin e Serbisë. Krahas fillimit të bombardimeve të caqeve serbe nga ana e NATO-s, Milosheviqi dha urdhër që forcat e veta në Kosovë të fillonin një fushatë terrori, e cila kaloi për nga përmasat, ashtu edhe për nga shpejtësia më të cilën u krye, edhe vetë spastrimin etnik që ai kreu në Bosnjën Lindore dhe Veriore gjatë vitit 1992.<sup>32</sup> Lufta e përbashkët e UÇK-së dhe e NATO-s rezultoi me çlirimin e territorit të Kosovës dhe largimin e plotë të forcave policore militare dhe paramilitare dhe atyre ushtarake, si dhe me largimin nga Kosova të administratës së dhunshme civile të Serbisë.

Fillimi i fushatës së bombardimeve të NATO-s ndaj Serbisë hapi debatet në lidhje me legalitetin, shkaqet dhe qëllimet e luftës, efektivitetin e fushatës së NATO-s, si dhe çështjet e tjera që lidheshin me promovimin e një doktrine të re ushtarake dhe me krijimin e rendit të ri ndërkombëtar. Këto debate dhe polemika buronin në faktin se ky ishte aksioni i parë ushtarak që ndërmori NATO-ja në historinë e saj

---

<sup>32</sup> Neol Molcolm, “*Të drejtat e Kosovës*”, botuar në librin *Lufta kundër luftës*, Tiranë, 2001, 96.

pesëdhjetëvjeçare pa mandatin formal të Këshillit të Sigurimit të OKB-së kundër një shteti sovran dhe përmasat e tij ishin shumë më të mëdha se ato të ndërmarra në Bosnjë, e cila çoi në përfundimin e luftës dhe arritjen e Marrëveshjes së Dejtonit më 1995.<sup>33</sup>

NATO-ja e nisi fushatën ajrore me qëllim që të parandalonte një katastrofë humanitare: vrasjen dhe dëbimin e shqiptarëve të Kosovës, si dhe të ruante sigurinë rajonale duke i imponuar Beogradit planin e paqes për Kosovën në Rambuje. Megjithatë, efekti imediat i sulmeve ajrore ishte i kundërt; ato përshpejtuan operacionet e spastrimit etnik nga forcat serbe, rezultati i së cilave ishte largimi dhe deportimi i rreth 1 milion shqiptarëve të Kosovës për në Shqipëri, në ish- Republikën Jugosllave të Maqedonisë, në Mal të Zi dhe në shumë shtete evropiane. Deportimi i refugjatëve dhe dyndja e tyre shtoi nga ana e saj edhe rrezikun e mundshëm të destabilizimit social të vendeve pritëse, fakt ky që e shtyu NATO-n të angazhonte burimet e veta për operacionet humanitare.<sup>34</sup> Fillimi i bombardimeve të NATO-s si dhe lufta çlirimtare që bënte UÇK-ja, ndikuan që Serbia, e përballur me humbjen e luftës, të fillojë aksione ndëshkuese ndaj popullsisë civile duke masakruar dhe me qindra civilë, fëmijë, gra dhe pleq dhe duke ushtruar një gjenocid të paparë që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore. Me të filluar bombardimet nga NATO-ja, Serbia filloi implementimin e planit të përgatitur më parë në qarqet e saja kuazishkencore për spastrimin etnik në Kosovë, një prej krimeve më të lemerishme kundër njerëzimit që janë kryer gjatë këtij shekulli, i krahasueshëm për nga natyra, edhe pse jo për nga numri, me Holokaustin e hebrenjve të realizuar nga Hitleri.

Në anën tjetër, udhëheqja e komanduar nga Millosheviqi e nisi luftën me shpresën se uniteti i 19 vendeve anëtare të NATO-s do të cenohej seriozisht po të zmadhoheshin humbjet e NATO-s dhe

<sup>33</sup> Shih më shumë: Gordon N. Bardos, “*Balkan History, Madeleine’s War, and NATO’s Kosovo*”, *Journal of the North American Society for Serbian Studies* 15(1): 77-102, 200, 96-100.

<sup>34</sup> Gabriel Partos, “*Kosova-mënyra të reja për të ndalur në konflikt të vjetër*”, botuar në librin *Lufta kundër luftës*, Tiranë, 2001, 102.

bombardimi të shkaktonte një numër të madh të viktimave civile. Megjithëse uniteti i NATO-s kaloi një provë të vështirë dhe nuk pati për pasojë ndalimin e as uljen e intensitetit të goditjeve ajrore. Përkundrazi, NATO-ja filloi dislokimin e forcave tokësore në rajon para se Beogradi të pranonte një marrëveshje, dhe kjo bëri që konflikti të zgjatë 11 javë, duke shkatërruar një pjesë të caqeve ushtarake dhe civile të Serbisë në Kosovë dhe Serbi dhe duke pasur për pasojë një numër të madh të viktimave civile. Sulmet e NATO-s kishin një motiv të lartë moral. Ky motiv bazohej në moslejimin e spastrimit etnik në Evropë në prag të shekullit XXI, si dhe ndaljen e një katastrofe të thellë humanitare. NATO-ja u vu në mbrojtje të parimeve të të drejtave të njeriut, të cilat kanë përparësi edhe në raport me sovranitetin e shteteve. Pikërisht kjo, e bëri të ligjshëm sulmin e saj ndaj Federatës Jugosllave, qoftë edhe pa mandatin e OKB-së.<sup>35</sup>

Me gjithë legjitimitetin e aksionit të NATO-s kundër Serbisë, ky aksion vu përballë kritikave nga drejtimitet e ndryshme. Disa thanë se NATO-ja nuk duhej të vepronte si xhandar ndërkombëtar, duke ndërhyrë pa mandatin e qartë të Kombeve të Bashkuara kundër një shteti sovran. Në anën tjetër, një numër i madh i ekspertëve të së drejtës ndërkombëtare kanë mbrojtur legalitetin e ndërhyrjes, me qëllim të parandalimit të katastrofës humanitare dhe shpëtimit të jetës së njerëzve. Baza juridike sipas këtyre ekspertëve është përcaktuar në Kaptinën VII të Kartës së OKB-së. Pas rënies së komunizmit në Evropë është mjaft i përhapur koncepti se një nga funksionet parësore të shteteve është mbrojtja, dhe jo persekutimi i qytetarëve dhe i çdo njeriu që jeton brenda kufijve të tyre. Kjo doktrinë e re është në pajtim me tendencën e krijimit të rendi të ri ndërkombëtar dhe me teorinë e sovranitetit të kufizuar shtetëror që filloi të promovohet me konfliktin në Kosovë dhe që mund të jetë një preventivë për konfliktet e tjera në baza etnike.

---

<sup>35</sup> Shih më shumë: Gordon N. Bardos, “*Balkan History, Madeleine’s War, and NATO’s Kosovo*”, *Journal of the North American Society for Serbian Studies* 15(1): 77-102, 200, 96-100.

Krahas bombardimeve të NATO-s, UÇK-ja arriti t'u kundërvihet sulmeve serbe dhe sadopak të mbrojtë popullsinë civile që kishte ngelur në Kosovë. Për më tepër, UÇK-ja i shkaktoi mjaft humbje armikut dhe e ndihmuar nga sulmet ajrore të NATO-s, fitoi shumë beteja dhe çliroi disa territore. Megjithatë, forcat serbe vranë dhe masakruan më shumë se 10 000 civilë shqiptarë, dogjën më tepër se 100 000 shtëpi, shkatërruan dhe plaçkitën pasurinë e shqiptarëve dhe morën si pengje dhe robër të luftës një numër të madh të shqiptarëve, për fatin e të cilëve as sot e kësaj dite nuk dihet asgjë. E ballafaquar me sulmet ajrore të NATO-s dhe luftën çlirimtare të UÇK-së, Serbia ndërmoi represaliet më brutale ndaj popullatës civile shqiptare me ç'rast shkeli në mënyrë flagrante Konventat e Gjenevës, të cilat përcaktojnë të drejtën e luftës. E ballafaquar me humbjen e sigurt të luftës, Serbia pranoi kapitullimin e saj dhe nënshkroi Marrëveshjen Tekniko-Ushtarake, të ashtuquajturën Marrëveshje e Kumanovës, e cila përcaktonte detajet teknike dhe ushtarake të tërheqjes së forcave policore dhe ushtarake të Serbisë nga Kosova dhe vendosjen e forcës së sigurimit ndërkombëtar (KFOR) në Kosovë.

### **Periudha e administrimit ndërkombëtar të Kosovës (1999-2008)**

Në Kosovë pas vitit 1999 u vendos administrimi ndërkombëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), si një mision i posaçëm pas dështimit të Marrëveshjes së Rambujesë. Ky administrim ishte një model i veçantë i krijuar vetëm për Kosovën dhe i njohur si Misioni i Kombeve të Bashkuara për Kosovë (United Nations Mission in Kosovo - UNMIK).

Ky mision, madje, krahasohet dhe është pak a shumë i njëanshëm me atë të Timorit Lindor (1999-2002), Afganistanit i vendosur në vitin 2002 apo edhe Kamboxhias i vendosur gjatë viteve 1992-1993.<sup>36</sup> Po ashtu, ky administrim ndërkombëtar ishte vendosur

---

<sup>36</sup> Simon Chesterman, *Justice Under International Administration: Kosovo, East Timor*

pas fushatës së bombardimeve të NATO-s, Konferencës së Rambujesë, si dhe rezistencës së armatosur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.<sup>37</sup> Pas përpjekjeve për arritjen e një marrëveshjeje me Serbinë, bashkësia ndërkombëtare për të shmangur një katastrofë të përmasave çfarë kishte ndodhur në Bosnjë- Hercegovinë, vendosën një administrim ndërkombëtar në Kosovës, i cili kishte për qëllim trasimin e rrugës së Kosovës drejt statusit final dhe shpalljes së pavarësisë, e cila u arrit tek pas 8 vjetëve të plota nën administrimin ndërkombëtar.

Mandati i misionit të OKB-së në Kosovës (UNMIK) është bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, si dhe ishte shoqëruar me Marrëveshjen e Kumanovës që legjitimoi hyrjen e trupave të NATO-s në Kosovë, si dhe largimin e trupave dhe administratës serbe nga Kosova. Rasti i Kosovës dhe administrimi i tillë ndërkombëtar cilësohej si një formë e protektoratit joklasik apo formë e veçantë e mbikëqyrjes së një shteti nga një organizatë ndërkombëtare apo nga shumë shtete.<sup>38</sup> Me të drejtë periudha prej vitit 1999-2008<sup>39</sup> në Kosovë mund të cilësohet si periudhë tranzicionale (kalimtare) si në aspektin e shtetndërtimit, ashtu edhe atë të krijimit të së drejtës. Gjatë kësaj periudhe kalimtare në Kosovë ishte krijuar një rend juridik i përkohshëm, i cili do të vlente deri në zgjidhjen e statusit përfundimtar dhe shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Periudha tranzitore në Kosovë mund të ndahet në tri faza kryesore:

1. Faza e parë dhe administrimi i Kosovës në mënyrë të plotë nga UNMIK-u<sup>40</sup> 1999-2001.

---

*and Afghanistan*”, International Peace Academy, shtator 2002, 3.

<sup>37</sup> Eric Herring “*From Rambouillet to the Kosovo Accords: NATO's War against Serbia and Its Aftermath*”, University of Bristol, 2012, 225-232.

<sup>38</sup> “*The New Kosovo Protectorate*”, ICG Balkans Report N°69, 20 June 1999, 5-6.

<sup>39</sup> Oliver Jens Schmitt, “*Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*”, botimet “Koha”. Prishtinë, Nëntor 2012, 265-266.

<sup>40</sup> Jürgen Friedrich, “*UNMIK in Kosovo: Struggling with Uncertainty*”, Max Planck UNYB 9 (2005), 255-256.

2. Faza e dytë dhe krijimi i institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës (IPVQ), 2001-2005.
3. Faza e tretë dhe përgatitja për zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës, 2005-2008; kjo fazë njihet edhe si faza e negociatave për statusin final të Kosovës.

### **Faza e parë e administrimit ndërkombëtar të Kosovës 1999-2001**

Administrimi ndërkombëtar i Kosovës filloi në vitin 1999 me miratimin e Rezolutës 1244 nga ana e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Në fazën e parë të këtij administrimi vendoset prania ndërkombëtare dhe ushtarake, përkatësisht administrata e UNMIK-ut dhe trupat e NATO-s të njohura si KFOR. Momenti i fillimit të fazës së parë të zbatimit të Rezolutës 1244 dhe administrimit ndërkombëtar lidhet me fillimin e zbatimit të Marrëveshjes Tekniko-Ushtarake të Kumanovës. Siç u theksua, kjo Marrëveshje është e lidhur në mes të Ushtrisë Jugosllave dhe NATO-s, si dhe e njëjta përcakton modalitetet e tërheqjes së forcave serbe nga Kosova.<sup>41</sup>

Faza e parë e administrimit ndërkombëtar të Kosovës, që përfshin vitet 1999-2001, karakterizohet me vakuum institucional, marrë parasysh që Kosova si një vend i dalë nga lufta kishte kaluar në një realitet krejt tjetër social, politik e juridik, duke bërë një shkëputje nga e kaluara. Në këtë fazë përpos institucioneve ndërkombëtare të bazuara në efektin e Rezolutës 1244 nuk ka pasur institucione vendore dhe ligje të zbatueshme, të cilat do të shërbenin për funksionimin e shtetit dhe shoqërisë së Kosovës. Bazuar në këtë që e thamë më lart, mund të përmendim disa karakteristika të kësaj faze të administrimit ndërkombëtar në Kosovë:

1. mungesën e rregullave kushtetuese të zbatueshme;
2. mungesën e ligjeve të zbatueshme;
3. mungesën e institucioneve shtetërore dhe legjitime.<sup>42</sup>

<sup>41</sup> Alexandros Yannis "Kosovo Under International Administration an Unfinished Conflict", 1999-2000, 9-13.

<sup>42</sup> Arsim Bajrami, "E drejta e Kosovës në tranzicion", Prishtinë 2002, 89-90.

Gjatë viteve 1999-2001, sa kishte zgjatur faza e parë e administrimit ndërkombëtar, ku përveç tjerash, në Kosovë ishin themeluar parti politike dhe ishin mbajtur zgjedhjet e para lokale (viti 2000), si një përpjekje për të krijuar institucionet e para legjitime. Këto zgjedhje në tërësi ishin organizuar dhe monitoruar nga organizatat ndërkombëtare dhe administrata e UNMIK-ut.<sup>43</sup> Po ashtu, për herë të parë në këto zgjedhje në realitetin e ri kosovar kishte gjetur shprehje pluralizmi politik si vlerë kushtetuese. Gjatë vitit 1999-2001, në mungesë të institucioneve qendrore, Kosova është qeverisur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) dhe administrata e UNMIK-ut, si dhe nga disa institucione të përbashkëta të krijuara, siç ishin: Këshilli Tranzitor i Kosovës dhe Këshilli i Përkohshëm Administrativ. Edhe pse menjëherë pas luftës, me vendosjen e Kosovës nën administrimin e UNMIK-ut për një kohë kishte funksionuar edhe Qeveria e Përkohshme e Republikës së Kosovës, qeveri kjo e dalë nga Marrëveshja e Rambujesë, mirëpo e njëjta me kërkesën e PSSP-së ishte shpërbërë shpejt për t'i dhënë mundësinë krijimit të institucioneve legjitime të dala nga zgjedhjet e lira.

### **Marrëveshja e Kumanovës dhe tërheqja e forcave serbe nga Kosova**

Siç e thamë edhe më lart, faza e parë e administrimit ndërkombëtar të Kosovës ka filluar me miratimin e Rezolutës 1244 dhe nënshkrimin e Marrëveshjes së Kumanovës, si marrëveshje tekniko-ushtarake. Nënshkrimi i Marrëveshjes Tekniko-Ushtarake midis ushtrisë jugosllave dhe NATO-s, të cilën e përfaqësonte gjenerali Mike Jackson, shënoi fundin e bombardimeve ajrore të NATO-s dhe pranimin e kushteve që ajo ia parashtrroi Serbisë për njohje të kapitullimit dhe për tërheqjen e forcave të saj nga territori i

---

<sup>43</sup> Albert J. Schmidt, "Toward the Rule of Law: Kosovo 2000 Elections", Vol. 20:467-2001], 485-486.

Kosovës. Kjo Marrëveshje përcaktoi modalitete tekniko-ushtarake të tërheqjes së forcave serbe nga territori i Kosovës, dinamikën e tërheqjes dhe hyrjen e forcës ndërkombëtare të sigurisë. Marrëveshja përmban gjithsej 6 nene dhe dy shtesa.

Në nenin e parë përcaktohen obligimet kryesore, në të cilat pala serbe pajtohet për vendosjen e prezencës civile të Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe pranimin nga ana e saj të vendosjes së Forcës së Sigurimit Ndërkombëtar (KFOR). Më tutje në këtë nen, Serbia pranon tërheqjen e të gjitha forcave të sigurimit të saj, duke përfshirë këtu të gjithë personelin dhe organizatat me aftësi militare të RFJ-së dhe Republikës së Serbisë nga territori i Kosovës. Në vazhdim të këtij neni, përcaktohet Zona e Sigurisë Ajrore (ASZ), e cila përfshin një zonë 25 kilometërshë që zgjerohet përtej kufirit rajonal të Kosovës. Zona e Sigurisë Tokësore (GSZ) definohet si zonë 5 kilometërshë që zgjerohet përtej kufirit rajonal të Kosovës.<sup>44</sup> Në këtë pjesë të marrëveshjes përcaktohen dy obligime kryesore, që rrjedhin nga marrëveshja:

1. Që të vendosen ndalimet e veprimeve ushtarake të qëndrueshme, nën asnjë rrethanë nuk duhet çfarëdo force federative dhe e Republikës së Serbisë të hyjë brenda, të rihyjë apo të mbetet brenda territorit të Kosovës apo në Zonën e Sigurisë Tokësore (GSZ) dhe në Zonën e Sigurisë Ajrore (ASZ), pa pëlqimin prioritar të Komandës së Forcës së Sigurisë Ndërkombëtare (KFOR).

2. Të sigurohet përkrahja dhe autorizimi i Forcës së Sigurisë Ndërkombëtare (KFOR) dhe, në veçanti, ta autorizojë KFOR-in të ndërmarrë aksione të tilla siç janë kërkuar, duke përfshirë edhe përdorimin e forcës së domosdoshme për të siguruar përkrahjen e kësaj marrëveshjeje dhe mbrojtjen e Forcës së Sigurisë Ndërkombëtare (KFOR) dhe të kontribuojë në ambientin e sigurisë të prezencës civile ndërkombëtare.<sup>45</sup>

<sup>44</sup> Marrëveshja e Kumanovës, 9 qershor 1999. E qasshme në

<http://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm>, qasur së fundmi më 10.07.2017.

<sup>45</sup> Po aty.

Në nenin 2 të Marrëveshjes përcaktohen detyrimet e ndaljes së menjëhershme të veprimeve ushtarake përfshirë kushtet, rrugët dhe dinamika e tërheqjes së forcave serbe dhe jugosllave nga territori i Kosovës dhe në distancë të zonës tokësore dhe ajrore të sigurisë. Krahas tërheqjes nga Kosova, forcat serbe dhe jugosllave detyrohen të shënojnë dhe pastrojnë të gjitha fushat e minuara në të gjitha linjat e komunikacionit. Më tutje, në këtë nen specifikohen saktësisht afatet e tërheqjes së forcave serbe nga Kosova. Dispozitat e nenit 3, 4, 5 dhe 6 kanë karakter teknik dhe u referohen mekanizmave të implementimit të marrëveshjes.<sup>46</sup>

Nënshkrimi i Marrëveshjes mundësoi fillimin e aksionit të vendosjes së Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë në Kosovë (KFOR) dhe largimin e forcave serbe nga Kosova. Ky fakt krijoi kushtet për rikthimin e refugjatëve kosovarë në Kosovë, kthim ky që u bë me një shpejtësi të madhe, që e habiti komunitetin ndërkombëtar. Pas hyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë, Këshilli i Sigurimit më 10 qershor, 1999 miratoi Rezolutën 1244, me të cilën edhe formalisht e vendosi Kosovën nën administrimin e Kombeve të Bashkuara dhe hapi rrugën për vendosjen e prezencës ndërkombëtare civile dhe ushtarake në territorin e Kosovës.

### **Miratimi i Rezolutës 1244**

Në aspektin juridik, kjo rezolutë paraqet akt konstitutiv të vendosjes së Kosovës nën administrimin e OKB-së duke vendosur një prezencë civile dhe ushtarake ndërkombëtare. Miratimi i kësaj rezolute i dha fund agresionit serb ndaj Kosovës dhe ndërpreu gjenocidin shtetëror serb, i cili synonte spastrimin etnik të Kosovës. Praktikisht, kjo rezolutë shënoi përfundimin e luftës çlirimtare të UÇK-së, e cila në sajë të ndihmës së NATO-s u kurorëzua me lirinë e Kosovës dhe largimin e forcave policore, ushtarake dhe të gjitha

---

<sup>46</sup> Marrëveshja e Kumanovës, 9 qershor 1999, neni 2. E qasshme në

<http://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm>, qasur së fundmi më 10.07.2017.

forcave paramilitare nga territori i Kosovës. Duke vendosur forcat e KFOR-it në territorin e Kosovës, miratimi i kësaj rezolute mundësoi kthimin e afër 1 milion shqiptarëve në Kosovë, të cilët gjatë kohës së luftës ishin deportuar me dhunë, në shumë shtete fqinje dhe anembanë botës. Administrimi Ndërkombëtar në Kosovë, i përcaktuar me Rezolutën 1244, është i karakterit të përkohshëm dhe synon krijimin e kushteve të përshtatshme demokratike për zgjidhjen e statusit final të Kosovës. Specificiteti i këtij modeli të administrimit ndërkombëtar, shprehet me faktin se, ai paraqet modelin e parë të OKB-së në përmasa kaq të gjera.

Ky model ishte specifik në Kosovë për faktin se ai krahas vendosjes së administratës civile dhe ushtarake ndërkombëtare, kombinohet edhe me një vetëqeverisje vendore dhe me një proces demokratik dhe institucional, i cili krahas eliminimit të shkaqeve të krizës dhe armiqësive ndëretnike, synon të merret me mënjanimin e shkaqeve që kanë prodhuar krizën, pra të zgjidhë burimin e krizës dhe të mundësojë një zgjidhje politike dhe statusore afatgjate të krizës. Në aspektin e përmbajtjes Rezoluta 1244, si akt konstitutiv i vendosjes së administrimit ndërkombëtar në Kosovë, më tepër është marrë me pasojat e krizës, sesa me burimin e saj. Ajo, në aspektin juridik dhe politik, e ka sanksionuar gjendjen e *status quo*-së, pra gjendjen që ka ekzistuar para rrënimit Kushtetutës të pozitës së Kosovës, të përcaktuar me Kushtetutën e vitit 1974.

Pra, Rezoluta 1244 ka përcaktuar një zgjidhje balancuese duke mos njohur okupimin institucional të Kosovës nga Serbia, që ka pasuar pas vitit 1990, (*kur Serbia në mënyrë kundërkushtetuese vendosi Kosovën në juridiksionin e plotë dhe vendosi zbatimin e politikës së gjenocidit shtetëror dhe politikën e aparteidit ndaj shqiptarëve si populli me shumicë dërmuese në Kosovë*).<sup>47</sup> Në anën tjetër, Rezoluta nuk e njeh dhe nuk e pranon shprehimisht deklarin

---

<sup>47</sup> Rezoluta 1244, 10 qershor 1999, e qasshme në:

[https://www.treasury.gov/resource center/sanctions/Programs/Documents/1244.pdf](https://www.treasury.gov/resource%20center/sanctions/Programs/Documents/1244.pdf),  
qasur së fundmi më 10.07.2016.

e mëparshëm politik të popullit të Kosovës, të shprehur në referendumin për Pavarësinë e Kosovës.

Megjithëse, Rezoluta promovon konceptin e vetëqeverisjes për Kosovën, kompetencat substanciale të karakterit shtetëror, rezervohen dhe ushtrohen nga Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-u), i cili paraqet autoritet përfundimtar në funksionimin e pushtetit në Kosovë në tri trajtat e tij: legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.<sup>48</sup> Kjo rezolutë u miratua në mbledhjen e 4011-të të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. E njëjta edhe gati 10 vjet pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës është në fuqi, meqenëse asnjëherë nga miratimi i saj nuk është nxjerrë një rezolutë tjetër, e cila do të nxirrte nga fuqia atë. Përveç tjerash në përmbajtjen e saj Rezoluta 1244 e njeht Kosovën si pjesë të ish-RSFJ-së,<sup>49</sup> si dhe nuk ka paraparë ndonjë datë të saktë se kur do të shpallej pavarësia e Kosovës apo ndonjë datë të saktë se kur do të përfundonte administrimi ndërkombëtar i Kosovës, fakt ky që ishte bërë pengesë dhe kishte zgjatur tej mase zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës.<sup>50</sup> E kemi thënë edhe më lart, në rastin e sqarimit të burimeve të së drejtës në Republikën e Kosovës që sot Rezoluta 1244 nuk ka ndonjë efekt juridik në sistemin kushtetues të Kosovës, mirëpo e njëjta prodhon efekt vetëm në raportet e Republikës së Kosovës në OKB dhe në disa segmente të tjera të subjektivitetit ndërkombëtar të shtetit të Kosovës.

### **Misionet dhe dështimet e UNMIK-ut në Kosovë**

Në vijim do të flasim për tre qëllimet e UNMIK-ut në Kosovë, apo tre misionet, të cilat mund të quhen relativisht të suksesshme, siç janë:

1. Krijimi i Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPV).

---

<sup>48</sup> Po aty.

<sup>49</sup> Jure Vidmar, “*International Legal Responses to Kosovo’s Declaration of Independence*”, *Vanderbilt Journal of Transnational Law*, [Vol. 42:7792009], 796-797.

<sup>50</sup> Jürgen Friedrich, “*UNMIK in Kosovo: Struggling with Uncertainty*”, *Max Planck UNYB* 9 (2005), 252-254.

UNMIK-u arriti që menjëherë pas funksionalitetit të misionit të saj në Kosovë të ndihmojë dhe monitorojë krijimin e institucioneve të para demokratike të Kosovës mbi bazën e Rezolutës 1244. Ky proces filloi me miratimin e Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme si bazë e përkohshme e krijimit të institucioneve demokratike në nivel lokal dhe qendror. Procesi i krijimit të institucioneve të përkohshme filloi përmes zgjedhjeve lokale të vitit 2000, me ç'rast u formuan pushtetet në nivel lokal apo të komunave në të gjithë territorin e Kosovës, u krijuan asamblatë komunale, u zgjedhën kryetarët e komunave, si dhe organet e tjera ekzekutive dhe kësaj u funksionalizua pushteti lokal i cili tërësisht monitorohej nga UNMIK-u. Pranë secilës komunë u vendos një administrator komunal, i cili kishte kompetenca analoge me PSSP-në në nivel qendror.

Kësaj administratori komunal monitoronte punën e kryetarëve të komunave dhe asambleve komunale me të drejtën e shfuqizimit të cilitdo akt, të cilin ai ose ajo vlerësonte se ishte në kundërshtim me Rezolutën 1244. Pastaj pas formimit të pushteteve lokale dhe miratimit të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme u mbajtën zgjedhjet e para parlamentare, mbajtjen e të cilave e përgatiti UNMIK-u dhe PSSP-ja, të cilat rezultuan me konstituimin e Kuvendit të parë të Kosovës në periudhën e pasluftës, me zgjedhjen e kryetarit të Kosovës apo presidentit të Kosovës, pra presidentit Rugova. Pastaj me formimin e Qeverisë së parë, krijimin e një administrate dhe me një funksionalitet të tri pushteteve, të cilat vepronin si institucione të përkohshme vetëqeverisëse. Pra, mund të thuhet suksesi i parë i UNMIK-ut në Kosovë ka qenë pikërisht ndërprerja e një kaosi institucional në periudhën e pasluftës, mënjanimi i dualizmave shqiptare që u trashëguan nga lufta. UNMIK-u pas shuarjes së dy qeverive paralele të Kosovës formoi organet e bashkëqeverisjes: Këshillin e Përkohshëm Administrativ dhe Këshillin Transitor të Kosovës. Ky mund të quhet suksesi i parë i UNMIK-ut, pra krijimi i menjëhershëm i një strukture bashkëqeverisëse në mënyrë që UNMIK-u të mos shndërrohet në një administratë koloniale. Me vonë, UNMIK-u hap pas hapi filloi të bartë përgjegjësinë e qeverisjes

tek institucionet vendore, gjithmonë duke ruajtur kontrollin dhe monitorimin nga ana e tij dhe respektimin e plotë të Rezolutës 1244, si dhe obligimeve të tjera që kishte marrë Kosova.

2. Krijimi i rendit juridik ishte misioni i dytë UNMIK-ut në Kosovë.

Kosova e pasluftës u ndesh me një vakuum të dyfishtë. Vakuum institucional, përkatësisht mungesë të institucioneve funksionale dhe me një vakuum ligjor, apo mungesë të ligjeve dhe legjislacionit me të cilin do të mund të vendosej një rend juridik. Vakuumi institucional kishte të bënte me faktin se Kosova pas luftës nuk kishte një qeveri të bashkuar. Kishte një qeveri që u formua në Rambuje si një qeveri e përkohshme dhe që asnjëherë nuk u plotësua me përfaqësuesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Po ashtu, kishte një qeveri në ekzil, e cila vepronte në mënyrë jofunksionale. Kësisoj periudha e pasluftës kërkoi si urgjencë vendosjen e një sistemi institucional që do t'i jepte fund këtij dualizmi dhe vakuimit institucional. Kjo u bë përmes dy rrugëve, e para përmes vendosjes së organeve konsultative të UNMIK-ut dhe të institucioneve të Kosovës, përkatësisht Këshillit të Përkohshëm Administrativ dhe Këshillit Transitor, ndërsa rruga e dytë ishte përmes krijimi të autoriteteve lokale dhe qendrore përmes zgjedhjeve lokale dhe atyre të përgjithshme të vitit 2000, përkatësisht 2001.

Krijimi i rendit juridik ishte një sfidë e veçantë, sepse ishte e domosdoshme që sa më shpejt të nxirren ligje, rregullore dhe akte të tjera me të cilat vihet baza e funksionimit të institucioneve të para demokratike. Në këtë drejtim, UNMIK-u përmes PSSP-së filloi miratimin e rregulloreve, të cilat kishin fuqi ligjore dhe të cilat rregullonin fusha të caktuara dhe që kishin fuqi legjislative. Një rëndësi të veçantë kishte Rregullorja nr. 24/99, e cila e ndalon veprimin e ligjeve të ish-Jugosllavisë dhe të Serbisë, të cilat kishin përmbajtje diskriminuese në raport me shqiptarët. Pra, të ashtuquajturat ligje të kohës së okupimit apo ligjet e kohës së Millosheviqit u shfuqizuan, duke i fuqizuar drejtpërdrejt konventat evropiane për të drejtat e njeriut dhe rregulloret e UNMIK-ut.

Pas zgjedhjeve dhe themelimit të IPV-së edhe ligjet e Kuvendit të Kosovës dhe aktet e ndryshme të qeverisë ishin burime të krijimit të rendit të ri juridik. Mund të thuhet se krijimi i rendit të ri juridik ka qenë një storie e suksesshme e misionit të UNMIK-ut, sepse kjo e fundit implementoi në Kosovë standardet më të larta sa u përket respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut duke bartur frymën e konventave evropiane për liritë dhe të drejtat e njeriut drejtpërdrejt në legjisllacionin e Kosovës. Në këtë drejtim janë arritur rezultate të mëdha, sepse janë miratuar me dhjetëra rregullore dhe udhëzime me anë të të cilave është vendosur bazamenti i krijimit të një rendi ligjor dhe juridik plotësisht të pavarur dhe në harmoni të plotë me standardet evropiane. Mbase është për t'u kritikuar fakti që edhe pse Kuvendi i Kosovës në këtë periudhë filloi nxjerrjen e ligjeve, këto ligje merrnin fuqi juridike vetëm pas nënshkrimit të tyre nga PSSP-ja. Kjo, në një masë e zbehte autoritetin e organeve të dala nga vota e popullit dhe tregonte fuqinë e UNMIK-ut në raport me institucionet vendore. Misioni i tretë i UNMIK-ut në Kosovë konsiderohet bartja graduale e përgjegjësiwe institucionale dhe qeverisëse tek institucionet vendore të qeverisjes. Detyra e UNMIK-ut sipas Rezolutës 1244 nuk ka qenë vetëm formimi i institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes, por edhe bartja hap pas hapi e këtyre përgjegjësiwe tek institucionet të dalë nga zgjedhjet me qëllim që këto të fundit të marrin përgjegjësi për udhëheqjen e Kosovës. Në këtë segment që nga legjisllatura e parë e vitit 2001 ka filluar ky proces ku UNMIK-u bartte përgjegjësitë e tij drejt institucioneve vendore qendrore dhe lokale.

Kjo bartje e përgjegjësiwe ndodhi përmes themelimit të departamenteve, të cilat kishin rolin e ministrive, përkatësisht departamenteve administrative në nivel qendror. Këto departamente në fazën e parë kishin një sistem dual të udhëheqjes nga një administrator ndërkombëtar dhe një udhëheqës vendor apo ministër në kuptimin e sotëm. Mund të thuhet se në këtë periudhë është krijuar edhe baza e administratës publike, ku siç do të shohim më vonë, ky proces shpeshherë është deformuar edhe me krijimin e një administrate të madhe apo një administrate me numër të zyrtarëve që

ka qenë rezultat i drejtpërdrejtë i këtij dualizmi të qeverisjes. Ky proces i bartjes së përgjegjësiave ka vazhduar legjislaturë pas legjislaturë e deri te Pavarësia e Kosovës, me ç'rast institucionet e Kosovës kanë marrë të gjitha kompetencat e UNMIK-ut, dhe nga ai moment mund të konsiderohet se misionit i UNMIK-ut në Kosovë ka përfunduar.

Dështimet e këtij Misioni janë të shumta dhe ato jo vetëm që e kanë vonuar Pavarësinë e Kosovës, por kanë paraqitur pengesë serioze në procesin e shtetndërtimit; qasja dogmatike e UNMIK-ut ka treguar paaftësinë e tij për të gjetur zgjidhje politike për statusin final të Kosovës. Kjo ka qenë edhe e pritshme, sepse UNMIK-u apo Kombet e Bashkuara edhe në vatrat e tjera të krizave në botë më tepër janë shquar si mekanizma paqeruajtës sesa si instrumente të zgjidhjeve politike. Do të theksojmë dhjetë kritikën apo dështimet e UNMIK-ut në Kosovë që tregojnë paaftësinë e këtij mekanizmi për të gjetur zgjidhje finale për Kosovën. Ato janë:

1. Si kritikë apo dështim i parë ka *qenë qëndrimi neutral i UNMIK-ut ndaj statusit të Kosovës*. Në të vërtetë, kjo ka qenë edhe pengesa kryesore, sepse UNMIK-u gjatë gjithë kohës nga momenti i vendosjes së misionit të tij e deri më sot e ka konsumuar plotësisht vetveten. Ai ka pasur një qëndrim neutral ndaj statusit të Kosovës, dhe kjo ka bërë që kjo strukturë fare të mos ketë një vizion të qartë për të ardhmen e Kosovës. Në një fazë të mëvonshme UNMIK-u bëhet edhe pengesë për gjetjen e zgjidhjes finale lidhur me statusin e Kosovës. Ky neutralitet i UNMIK-ut derivon nga Rezoluta 1244, e cila kishte bartur edhe frymën e Rambujesë, që për Kosovën parashihte një autonomi substanciale brenda Federatës Jugosllave. UNMIK-u gjatë gjithë kohës, përfshirë edhe sot kur ai vepron në një strukturë shumë të kufizuar në veri të Kosovës, është përpjekur që të ketë një qëndrim neutral ndaj statusit të Kosovës dhe të mos e prejudikojë atë. Kjo padyshim paraqet kritikën më të ashpër që mund t'i bëhet këtij Misioni në Kosovë, sepse ky ndonjëherë sikur ka harruar që është Misioni i Përkohshëm dhe siç thotë edhe vetë Rezoluta 1244 në pikën

11, është në pritje të zgjidhjes së statusit final. Pra, qëllimi parësor i UNMIK-ut nuk ka qenë ruajtja e *status quo*-së, por, në të vërtetë, shpejtimi i procesit të definimit të statusit final duke e ndihmuar këtë proces dhe duke lejuar që ky proces të bëhet në mënyrë demokratike edhe sipas premtimit të dhënë në Rambuje në klauzolën e cila shqiptarëve të Kosovës ua garantonte mundësinë e mbajtjes së një referendumi për shprehjen e vullnetit lidhur me statusin final të Kosovës. Mirëpo, UNMIK-u u tregua i paaftë për të zgjidhur statusin final të Kosovës, apo, siç me të drejtë, konstaton akademik Nexhat Daci: “Ishte pa koncept, pa strategji dhe pa vullnet për ndërtimin e shtetit të Kosovës”.<sup>51</sup>

2. Kritika e dytë ka të bëjë me *konceptimin e gabuar të sovranitetit*. UNMIK-u kishte një perceptim të gabuar për sovranitetin në Kosovë duke e atribuar veten si autoritet sovran dhe duke e arsyetuar sovranitetin e saj me Rezolutën 1244. Ky ishte një qëndrim tërësisht kolonial ndaj Kosovës, sepse UNMIK-u e kishte konceptuar që ai është autoritet sovran në Kosovë, dhe ai sovranitet i është dhënë në bazë të Rezolutës 1244. PSSP-ja paraqiste autoritet final në fushën legjislativë, gjyqësore dhe ekzekutive, dhe kjo në një mënyrë binte ndesh me parimin e demokracisë së sovranitetit të takon popullit. Ky konceptim i gabuar i sovranitetit është shprehur sidomos në mosrespektimin e plotë të vullnetit të popullit të shfaqur përmes zgjedhjeve të lira dhe demokratike me rastin e konstituimit të Kuvendit të Kosovës, Qeverisë dhe presidentit, të cilat kanë dalë nga vota e popullit dhe të cilat janë monitoruar plotësisht nga UNMIK-u dhe PSSP-ja me të drejtën e vetos. Kjo tendencë ka qenë në kundërshtim me parimin e legjitimitetit dhe sovranitetit popullor. Jo rrallë kishte një zhgënjim të madh në popull ku pikërisht UNMIK-u dhe PSSP-ja kanë delegitimuar ligjet dhe aktet e tjera të miratuara nga Kuvendi i Kosovës si bartës i sovranitetit popullor. Pikërisht, konceptimi i gabuar i sovranitetit popullor ka bërë që UNMIK-u

---

<sup>51</sup> Nexhat Daci, “*Lindja e vështirë e shtetësisë së Kosovës*”, botim i ASHAK-ut, Prishtinë, 2018, 25.

shpeshherë të ketë qasje koloniale e dogmatike dhe mbikëqyrëse ndaj popullit të Kosovës dhe institucioneve të saj dhe në një mënyrë të harrojë që ky mision është i përkohshëm dhe ka për qëllim dorëzimin sa më shpejt të qeverisjes te populli i Kosovës, i cili përmes zgjedhjeve do t'i legjitimojë institucionet e veta.

3. Kritika e tretë ka të bëjë me *krijimin e një administrate heterogjene joefikase me sistemin dual të qeverisjes*. Duke pasur një sistem dual të qeverisjes është krijuar një sistem i komplikuar i vendimmarrjes së një administratë tejet heterogjene dhe shpeshherë joefikase për faktin që UNMIK-u nuk ka paraqitur një strukturë homogjene. Në përbërjen e UNMIK-ut kanë qenë zyrtarë, nëpunës dhe administratorë që vinin nga shtetet me kulturë dhe sisteme të ndryshme juridike. Kjo ka bërë që të mos kemi një qeverisje harmonike të UNMIK-ut, po mjaft kontradiktore dhe shpeshherë edhe joprofesionale. Si pjesë e udhëheqjes së UNMIK-ut kemi pasur edhe administratorë të vendeve, të cilat nuk kanë fare përvojë në qeverisje apo nuk kanë fare kulturë juridike, dhe kjo ka bërë që me Kosovën nganjëherë edhe të eksperimentohet me gjetjen e një sistemi funksional të qeverisjes. Mendoj që edhe sot pengesat, të cilat i kemi në administratën publike, faktin që kemi një mbingarkim në administratën publike burimin e kanë pikërisht nga kjo qasje e UNMIK-ut për të krijuar një administratë të madhe me një sistem dual të qeverisjes. U krijuan shumë departamente me sistemin e dyfishtë të marrjes së vendimeve. Sot kur Kosova kritikohet në të gjitha raportet e progresit për administratë publike, duhet rikujtuar se gjeneza e kësaj administrate kaq të madhe buron nga UNMIK-u, i cili ka vendosur konturat e para të saj.

4. Një kritikë tjetër ndaj UNMIK-ut është *ruajtja e status quo-së në Kosovë*. UNMIK-u sikur harroi që misioni i tij në Kosovë është i përkohshëm dhe duhet sa më parë ta përfundojë misionin, duke afruar Kosovën drejt statusit final. Ardhja e administratorëve të ndryshëm nga shtetet e ndryshme bëri që UNMIK-u të mbetet në kuadër të *status quo-së*, të administrojë paqen dhe procesin e rindërtimit, por assesi të

ketë një vizion për dalje nga Kosova. Pra, i ka munguar një strategji dalëse apo *exit door* në mënyrë që të ketë një vizion që ky mision të përfundojë dhe të barten kompetencat tek institucionet vendore. Kësisoj krijohet përshtypja se UNMIK-u u shndërrua në një strukturë për realizimin e karrierave diplomatike për shumë zyrtarë të shteteve të ndryshme. Ata u akomoduan me realitetin e Kosovës dhe fare s’kishin vullnet politik për ta ndërprerë *status qou*-në dhe për të shkuar drejt zgjidhjes së statusit final. Mund të themi se ky koncept i ruajtjes së *status qou*-së dhe lëvizjes shumë të ngadalshme të UNMIK-ut për bartjen e kompetencave apo, siç thuhet në gjuhën popullore, lëvizjen me “hapa të breshkës” bëri që në Kosovë të akumulohet një pakënaqësi e madhe me gjendjen e *status qou*-së, me mungesën e një prespektive për popullin e Kosovës. Kjo pakënaqësi ka shpërthyer në ngjarjet e marsit 2004, të cilat patën efekte shumëdimensionale dhe treguan fragjilitetin e një gjendjeje që kishte vendosur UNMIK-u, pa perspektivë dhe pa vizion për statusin final të Kosovës.

5. Në këtë drejtim UNMIK-u bëri edhe një dështim tjetër, pra kritika tjetër ka të bëjë me *dështimin e UNMIK-ut në menaxhimin e drejtësisë tranzicionale në Kosovë*. Në fakt, ky është një dështim ligjor dhe juridik i UNMIK-ut. Ai (UNMIK-u) nuk arriti që përmes sistemit gjyqësor që administrohej nga ky mision të vendosë drejtësinë tranzicionale në Kosovë duke gjykuar dhe ndëshkuar krimet e luftës që kishin ndodhur në Kosovë. Veçanërisht UNMIK-u dështoi që të merret me krimet serbe në shkallë të gjenocidit për të gjykuar kriminelët serbë që kishin bërë krime monstruoze në Kosovë. Një pjesë e këtyre kriminelëve serbë ende jetojnë në pjesën e veriut të Kosovës. Si autoritet final gjyqësor në Kosovë, UNMIK-u nuk bëri fare përpjekje për të vendosur drejtësinë tranzicionale, për të ngritur akuza ndaj kriminelëve serbë që ishin të njohur me emër dhe mbiemër, për të hapur temat shumë të rënda nga lufta e fundit, siç është dhunimi i femrave shqiptare, çështja e personave të pagjetur, çështja e varrezave masive, çështja e pengjeve të luftës, çështja e të burgosurve etj.

6. Dështimet e tjera të UNMIK-ut kanë të bëjnë *me paaftësinë e tij për të shpërbërë strukturat paralele serbe në Kosovë*. Në fakt, gjatë gjithë kohës së administrimit të UNMIK-ut jo vetëm që janë toleruar strukturat paralele antikushtetuese serbe në Kosovë, por jo rrallë është bashkëpunuar edhe me këto struktura kriminale. Pra, është fjala për strukturat e Serbisë të vendosura në pjesën veriore të Kosovës dhe komunat e tjera me shumicë serbe që drejtpërdrejt zbatonin ligjet e Serbisë, nuk respektonin UNMIK-un dhe autoritetet vendore. UNMIK-u kishte detyrim ligjor të vendoste rendin unik juridik dhe të garantojë sovranitetin territorial të Republikës së Kosovës, natyrisht edhe me ndihmën e KFOR-it si strukturë ushtarake. Mund të thuhet se lejimi i veprimit të strukturave paralele serbe në Kosovë, njohja e atyre strukturave dhe bashkëpunimi me to nga ana e UNMIK-ut, ka bërë që këto struktura të forcohen vazhdimisht dhe të paraqesin pengesë serioze për ruajtjen e sistemit unik. Edhe sot e kësaj dite kur këto struktura veprojnë në territorin e Kosovës, mund të thuhet se UNMIK-u ka peshën kryesore të përgjegjësisë për tolerimin e veprimit të tyre, duke përfshirë edhe strukturat kriminale që vepronin në formë të bandave dhe grupeve të ndryshme kriminale në veri të Kosovës. UNMIK-u nuk lejonte që institucionet të vepronin me mjete ligjore në veri të Kosovës, përfshirë edhe dërgimin e policisë së Kosovës apo TMK-së në mënyrë që të vendoste rendin dhe ligjin.

### **Institucionet shtetërore në Kosovë në fazën e parë të administrimit ndërkombëtar 1999-2001**

Njëra ndër karakteristikat e fazës së parë të administrimit ndërkombëtar ka qenë mungesa e institucioneve vendore dhe baza kushtetuese për krijimin e tyre. Baza e vetme e funksionimit të institucioneve ishte Rezoluta 1244 dhe roli i PSSP-së në zbatimin e kësaj Rezolutive. Në kushtet e vakuimit të plotë institucional gjatë kësaj periudhe Kosova qeverisej në tërësi nga PSSP-ja dhe administrata e UNMIK-ut. Në bazë të Rezolutës 1244, UNMIK-u dhe PSSP-ja kishin

për qëllim krijimin e institucioneve dhe mekanizmave vendorë për qeverisjen dhe bashkëqeverisjen e Kosovës. Konform këtij qëllimi në vitin 2000 janë krijuar Këshilli Tranzitor i Kosovës dhe Këshilli i Përkohshëm Administrativ si institucione të përbashkëta.<sup>52</sup>

### **Struktura e UNMIK-ut dhe Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, PSSP**

PSSP-ja ishte autoriteti i Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Ai ushtronte tërë pushtetin ekzekutiv dhe ishte autoriteti përfundimtar legjislativ në Kosovë deri pas shpalljes së pavarësisë. Roli i PSSP-së lidhej me plotësimin e vakuimit institucional që ekzistonte në Kosovë, si autoritet përfundimtar. Mandati dhe autoriteti i PSSP-së buronte nga Rezoluta 1244. PSSP-ja ishte shef i administratës ndërkombëtare të UNMIK-ut dhe i raportonte drejtpërdrejt OKB-së, përkatësisht Këshillit të Sigurimit. Mandati i tij si autoritet përfundimtar vazhdoi edhe pas miratimit të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, 2001.

PSSP-ja kishte ushtruar autoritetin e saj për të mbuluar vakuumin institucional gjatë viteve 1999-2001, deri në krijimin e institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës. PSSP-ja duke shfrytëzuar kompetencat e saj ekzekutive në vitin 2000 kishte krijuar Këshillin Tranzitor dhe Këshillin e Përkohshëm Administrativ të Kosovës, si struktura të përbashkëta vendore dhe ndërkombëtare për qeverisjen e Kosovës. Kohëzgjatja e mandatit të PSSP-së ka qenë dhe është e lidhur me fatin e Rezolutës 1244 dhe përfundon me shfuqizimin e kësaj rezolute. Kompetencat e PSSP-së kanë qenë jashtëzakonisht të mëdha deri në hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës 2008. Pas hyrjes në fuqi të Rezolutës 1244, më datë 14 janar 2000, PSSP-ja dhe administrata e UNMIK-ut me qëllim të integritit dhe të themelimit të institucioneve të Kosovës kishte

---

<sup>52</sup> Jürgen Friedrich, “UNMIK in Kosovo: Struggling with Uncertainty”, Max Planck UNYB 9 (2005), 256.

themeluar strukturën e përbashkët të përkohshme administrative të Kosovës. Siç e kemi theksuar edhe më lart institucionet kryesore të strukturës së përbashkët ishin Këshilli Tranzitor dhe Këshilli i Përkohshëm Administrativ.<sup>53</sup> Pjesë e kësaj strukture ishin edhe departamentet administrative dhe administrata lokale.<sup>54</sup>

### **Këshilli i Përkohshëm Administrativ**

Këshilli i Përkohshëm Administrativ ishte organ i përbashkët ndërkombëtar dhe vendor, i cili përbëhej nga tetë anëtarë të emëruar nga PSSP-ja, prej tyre katër anëtarë ishin nga Kosova dhe katër të tjerë nga UNMIK-u. Në përbërjen katëranëtarëshe nga Kosova të këtij institucioni të përkohshëm njëri prej tyre ishte i nacionalitetit serb. Në përbërjen prej katër anëtarëve që vinin nga UNMIK-u të Këshillit të Përkohshëm Administrativ ishin: zëvendësi kryesor i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, zëvendësi i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Administratë Civile, zëvendësi i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Demokratizim dhe Ndërtim të Institucioneve dhe zëvendësi i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Rindërtim Ekonomik.<sup>55</sup> Ky Këshill kishte edhe dy anëtarë vëzhgues, njëri nga shoqëria civile dhe që ishte nga Kosova dhe tjetri ishte zëvendësi i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Çështje Humanitare.<sup>56</sup>

Këshilli i Përkohshëm Administrativ kishte kompetencë kryesisht të karakterit legjislativ, me ç'rast i jepte rekomandime PSSP-së për nxjerrjen e rregullave të reja në fuqi, të cilat kanë qenë të vlefshme për atë periudhë në Kosovë. Këshilli i Përkohshëm Administrativ gjatë funksionimit të tij si institucion i përbashkët ka mbajtur mbledhje të rregullta, të paktën një herë në javë që janë udhëhequr nga PSSP-ja. Vendimet në Këshillin e Përkohshëm

<sup>53</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2000/1, 14 Janar 2000.

<sup>54</sup> Po aty, neni 7 dhe 8.

<sup>55</sup> Po aty, neni neni 4.

<sup>56</sup> Po aty.

Administrativ janë marrë kryesisht me konsensus dhe të njëjtat kanë mundur të prishen nga PSSP-ja, në rast se i njëjti kishte vendosur ndryshe,<sup>57</sup> pra sipas rregullores ku vendimet konsideroheshin të vlefshme nëse merrnin shumicën e votave.<sup>58</sup>

Në parim gjatë punës së tij ky institucion kishte funksionuar më shumë si një trup politik sesa si një organ qeverisës. Përveç se ky Këshill në takimet e tij kryesisht javore kishte diskutuar gjendjen politike në Kosovë, i njëjti kishte rekomanduar për PSSP-në edhe rregullore të caktuara, të cilat kanë hyrë në fuqi me nënshkrimin nga PSSP-ja, si autoritet përfundimtar.<sup>59</sup> Në kohën e funksionimit të Këshillit të Përkohshëm Administrativ rregulloret e UNMIK-ut e kanë pasur fuqinë e ligjit dhe, në praktikë, kanë prodhuar efekte dhe pasoja të njëjta me ligjin (*efekte erga omnes*). Këshilli i Përkohshëm Administrativ ka pushuar së funksionuari pas mbajtjes së zgjedhjeve të para parlamentare në vitin 2001 dhe është zëvendësuar me krijimin e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës (IPVQ).

### **Këshilli Tranzitor i Kosovës**

Këshilli Tranzitor i Kosovës ishte një organ i gjerë politik, që kishte natyrë konsultative dhe politike. Për dallim nga Këshilli i Përkohshëm Administrativ, Këshilli Tranzitor nuk kishte kapacitete vendimmarrëse. Këshilli Tranzitor përbëhej nga një numër i madh i anëtarëve, të cilët ishin kryesisht përfaqësues të partive politike, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të bashkësive etnike dhe fetare. Gjatë punës së tij Këshilli Tranzitor ishte marrë kryesisht me diskutime të gjera politike, ku përfaqësoheshin kryesisht qëndrimet e partive politike dhe nuk merrte ndonjë veprim konkret.<sup>60</sup>

Përpos organeve, siç ishin Këshilli i Përkohshëm Administrativ dhe ai Tranzitor si organe të përbashkëta ishin edhe departamentet

<sup>57</sup> Arsim Bajrami, “*E drejta e Kosovës në tranzicion*”, Prishtinë 2002, 93.

<sup>58</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2000/1, 14 Janar 2000.

<sup>59</sup> Arsim Bajrami, “*E drejta e Kosovës në tranzicion*”, Prishtinë 2002, 93.

<sup>60</sup> Po aty, 93-94.

administrative, të cilat kryenin detyrat dhe punët e përkohshme në zbatim të vendimeve dhe politikave të Këshillit të Përkohshëm Administrativ, fushat e caktuara të punëve publike, siç janë: fusha e zhvillimit ekonomik, fusha e bashkëpunimit me donatorë, arsimi dhe shkenca, tregtia dhe industria, kultura, drejtësia, transporti dhe telekomunikacioni, shëndetësia, mirëqenia sociale, mbrojta e ambientit, bujqësia, siguria publike, emigracioni, administrata lokale etj.<sup>61</sup> Lindja e Republikës së Kosovës ishte një proces logjik i shkatërrimit të Federatës Jugosllave, i ushtrimit të së drejtës së vetëvendosjes së popullit shqiptar të Kosovës që të ketë shtetin e vet, të vendosë për fatin e vet pas shkatërrimit të Federatës Jugosllave dhe i krijimit të rrethanave gjeopolitike si pasojë e fundit e sistem komunist dhe lindjes së sistemeve demokratike. Rruga drejt realizimit të aspiratave të shprehura në Deklaratën Kushtetuse dhe në Kushtetën e Kaçanikut në fillimet e vitit 1991 nuk ishte aspak e lehtë, sepse në këtë kohë filloi odisejada tragjike e shpërbërjes së Jugosllavisë, pra luftat në territorin e Jugosllavisë fillimit në Slloveni, Kroaci dhe pastaj në Bosnjë dhe në Kosovë. Kosova deri në vitin 1995-1996 kishte zgjedhur rrugën paqësore, rrugën joviolente të udhëhequr nga presidenti Ibrahim Rugova për t'i ikur një tragjedie me përmasa shumë më të mëdha dhe tragjike për popullin shqiptar të Kosovës.

Kosova u pavarësua përmes një procesi të pavarësisë së koordinuar duke i dhënë fund përpjekjeve të popullit të Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare për zgjidhjen e statusit final të Kosovës. Natyrisht, rolin vendimtar në këtë proces e kishin Shtetet e Bashkuara të Amerikës edhe shtetet e Bashkimit Evropian, në radhë të parë Anglia, Franca, Gjermania, Italia etj.

Shtetet e Grupi i Kontaktit arritën paraprakisht konsensusin që Kosova të shpallë pavarësinë mbi bazën e Planit të Ahtisaarit dhe të ndodhë njohja ndërkombëtare e Kosovës si një shtet sovran dhe i pavarur. Mund të themi se klasa politike e Kosovës, lidërshipi i Kosovës asnjëherë nuk ka qenë më unik, më i përgatitur, më i

---

<sup>61</sup> Po aty, 94.

vendosur në historinë e saj politike se sa në fund të vitit 2007 dhe në fillim të vitit 2008 kur u përgatit shpallja e Pavarësisë së Kosovës, e cila u shpallë solemnisht më 17 shkurt 2008. Në fakt u arrit një konsensus i plotë nacional për shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, për marrjen e të gjitha masave që ky shtet të lindë pa shkaktuar një luftë lokale me serbët dhe për respektimin në tërësi të planit të presidentit Ahtisaari. Duhet theksuar se Pavarësia e Kosovës nuk është një koncesion apo një dhuratë që i është bërë popullit të Kosovës nga bashkësia ndërkombëtare. Përkundrazi, është pranimi i një të drejte të mohuar me shekuj të popullit të Kosovës nga bashkësia ndërkombëtare. Pra, në një mënyrë, është një përmisim i gabimeve historike që kishin bërë ndaj shqipëtarëve të Kosovës në Konferencën e Berlinit, në Konferencën e Londrës ku territori i Kosovës i ishte dhënë nën administrim Serbisë, përkatësisht Jugosllavisë.

Lindja e shtetit të pavarur të Kosovës dhe njohja ndërkombëtare e tij është rikthimi i drejtësisë në vend. Edhe pse mund të quhet një rast i drejtësisë së vonuar është një drejtësi që pak a shumë shpërblen sakrificën shekullore të popullit të Kosovës. Përfundimisht, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë erdhi në përfundimin, se miratimi i Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës e datës 17 shkurt 2008 nuk e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare të përgjithshme, Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit 1244 (1999) ose Kornizën Kushtetuese. Si rrjedhojë, miratimi i asaj deklaratë nuk e shkeli asnjë rregull të zbatueshëm të së drejtës ndërkombëtare